

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 9-2010

Funksionimi dhe Qeverisja Demokratike e Shërbimeve të Inteligjencës

Sofije Kryeziu

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Kryeziu, Sofije, "Funksionimi dhe Qeverisja Demokratike e Shërbimeve të Inteligjencës" (2010). *Theses and Dissertations*. 392.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/392>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Fakulteti për Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci

Funksionimi dhe Qeverisja Demokratike e Shërbimeve të Inteligjencës

Diplomë Bachelor

Sofije Kryeziu

Shtator/2010

Prishtinë



Fakulteti për Drejtësi Shkenca Politike dhe Diplomaci

Punim Diplome Bachelor

Viti Akademik 2007 – 2010

Studentja: Sofije Kryeziu

Funksionimi dhe Qeverisja Demokratike e Shërbimeve të Inteligjencës

Mentori: Dr. Ramadan Qehaja

Shtator/2010

Kjo temë është paraqitur në plotësimin e kërkesave për Diplomë Bachelor

FALENDERIM

Si rezultat i këtij punimi të Diplomes shfrytëzoj rastin ti falenderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në një mënyrë apo tjetër për mbarëvajtjen e gjithë procesit.

Së pari falenderoj prof. Ramadan Qehaja i cili përpos që na ka ligjeruar lënden “Studime të Sigurisë” gjatë semestrit të fundit të studimeve, ai poashtu ka ndarë përvojën e tij praktike me ne gjë që na ka ndihmuar që përpos njohurive teorike të kishim edhe një fotografi më të çartë përse i përket praktikës e cila siq na ka mësuar përvoja dallon shumë për nga teoria, sidomos në këtë çështje kaq të rëndësishme dhe delikate siq është siguria.

Falenderim meritojnë edhe Mentor Vrajolli dhe Skender Përteshi nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) të cilet duke u bazuar nga përvoja e tyre në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe në përgjithësi në hulumtime e kërkime shkencore kanë ndarë idetë dhe sygjërimet e tyre për temën në fjalë.

Poashtu falenderoj profesorin Florian Qehaja i cili më ka ndihmuar në përzgjedhjen e temës, më ka dhënë informata e nevojshme duke më ofruar të gjitha publikimet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) si dhe partnerëve të saj të ndërlidhura me temën që do shtjelloj por edhe në përgjithësi me sektorin e sigurisë. Njëherish ai poashtu ka qenë asistent në universitet i cili ka ligjeruar në mënyrë mjaftë interaktive lënden “Studime të Sigurisë” duke na mundësuar që përpos përfitimit të njohurive dhe informacioneve në këtë sferë të shprehim perceptimet tona personale duke krijuar ide më të çarta dhe më të sakta për sektorin të sigurisë në përgjithësi dhe situatën në Kosovë në veçanti.

Një falenderim të posaqëm meriton edhe familja ime e cila më ka mbështetur fillimisht materialisht dhe moralisht gjatë tri viteve të studimeve si dhe procesit të përfundimit të temës së diplomes.

PËRMBAJTJA

FALENDERIM.....	4
PËRMBAJTJA.....	5
1. PARATHËNIE	7
2. HYRJE.....	9
3. METODOLOGJIA E PËRDORUR/VËSHTIRËSITË	11
4. ROLI I SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS NË SIGURINË KOMBËTARE	12
4.1. Metodatat e Grumbullimit të Informacionit.....	13
4.2. Disiplinat e Grumbullimit të Informacionit.....	14
4.3. Procesi (cikli) aktiviteteve në Inteligjencës	15
5. HISTORIKU I SHËRBIMIT TË INTELIGJENCËS NË NIVEL NDËRKOMBËTAR .	17
5.1. Shembuj të Shërbimeve të Inteligjencës në Botë	18
5.1.1. Shërbimet Inteligjente në ShBA	18
5.1.2. Shërbimi Inteligjent i Ruisë	19
5.1.3. Shërbimet Inteligjente në Mbretërinë e Bashkuar	20
5.1.4. Shërbimi Inteligjent Izraelit.....	20
6. ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE INTELIGJENTE NE KOSOVË DERI NË VITIN 2008	21
6.1. Shërbimet e inteligjencës deri në periudhën e vitit 1999	21
6.2. Shërbimet e Inteligjencës deri në periudhën e vitit 2008	22
7. KRIJIMI I AGENCISË SË KOSOVËS PËR INTELIGJENCË – 2008	24
7.1. Infrastruktura Ligjore	24
7.2. Struktura e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	26

7.2.1. Drejtori.....	26
7.2.2. Zëvendës drejtori	27
7.2.3. Inspektori i Përgjithshëm.....	27
7.2.4. Punonjësit e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	28
8. RENDËSIA E INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA.....	30
8.1. Nivelet e Klasifikimit.....	31
8.2. Deklasifikimi i Informacionit.....	33
8.3. Siguria e Përsoneelit.....	33
9. KONTROLLI NGA INSTITUCIONET SHETETËRORE.....	37
9.1. Bashkëpunimi brenda shtetëror	37
9.2. Mbikëqyrja nga ana e Ekzekutivit – Qeveria	38
9.3. Mbikëqyrja nga ana e Legjislativit – Parlamenti	39
9.4. Roli i Gjqësorit.....	41
9.5. Roli i Institucioneve të Pavarura Shtetërore, Shoqërisë Civile dhe Mediave	43
9.6. Roli i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.....	44
10. GJETJET KRYESORE NË KUADËR TË FUNKSIONIMIT TË AKI.....	46
10.1. Mangësitë ligjore.....	46
10.2. Mangësitë në Implementim.....	46
10.3. Mungesa e Kapaciteteve Profesionale.....	47
11. PËRMBYLLJA.....	48
12. REKOMANDIMET.....	49
BIBLIOGRAFIA	51

1. PARATHËNIE

Duke qenë se fokusi kryesor i studimeve të departamentit në të cilin kam studiuar ka qenë drejtësia, marrëdhënjet ndërkombëtare, politika e jashtme, e drejta ndërkombëtare dhe diplomacia, aspekte këto të cilat si primare kanë pasqyrimin e imazhit të shteti ligjor dhe funksional, vlerësimi i nivelit të funksionalizimit të mekanizmave të sigurisë më së miri do të i shërbejë elaborimit të progresit të arritur në fushat e lartpërmendura. Në momentin që vie tek një rrezikim i rendit dhe sigurisë, përpos që mund të ndikoj në humbje në njerëz, humbje materiale – dobësimin e ekonomisë së vendit e të tjera, në raste të caktuara mund të mund të ndikojë në rrezikimin dhe humbjen e sovranitetit të shteteve.

Vlerësimi i shkaqeve dhe pasojave të rrezikimit të rendit dhe sigurisë dhe cënimit të sovranitetit është shtytja kryesore për përcaktimin tim në këtë temë. Në këtë drejtim duke pasur parasysh rolin që kanë agjencitë e inteligjencës në grumbullimin e informacioneve esenciale për rendin dhe sigurinë e vendit ky vlerësim ka për qëllim elaborimin e rolit dhe bazës ligjore për funksionimin e tyre.

Ky punim diplome përshkruan mënyren e veprimit të institucioneve të shërbimit të inteligjencës dhe mbikëqyrjen demokratike gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në mbrojtjen e sigurisë së vendit. Punimi synon të përshkruaj në mënyrë të detajuar rolin e këtij shërbimi të paraparë me infrastrukturën ekzistuese ligjore. Po ashtu vlerësohet fushëveprimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI) në raport me akterët tjerë përfshirë cënimin e mundëshëm të të drejtave dhe lirive të njeriut në raport me qytetarët si rezultat i veprimeve të këtij agjensioni.

Përcaktimi për një temë të kësaj natyre mjaftë senzitive, është për të theksuar e shpjeguar rëndësinë e shërbimeve inteligjente në Kosovë me fokus të veçantë në rolin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë që ka në procesin e ndërtimit të një shoqërie stabile dhe vendi të sigurtë jo vetëm për qytetarët e vet por edhe të kontribuojë në këtë mënyrë më gjerë në rajon. Kjo gjë jo vetëm që është njeri ndër faktorët jetik të funksionimit të mirëfilltë të shtetit, por

gjithashtu ndikon në forcimin e marrëdhënieve ndërshtetërore dhe nëse jo çdo herë në krijimin e miqëve atëherë gjithsesi në zvogëlimin e armiqëve.

2. HYRJE

Si në shumicën e shtetëve të botës, nevoja për sigurimin e shtetit lindi nga kërcënimet e ndryshme të jashtme dhe të brendshme, kimit të organizuar, terrorizmit, spiunazhit, trafikimit të qenieve njerëzore, armëve dhe shumë faktorëve të tjerë negative që ndikojnë në rrezikimin e mirëqenies së shoqërisë dhe shtetit në përgjithësi. Edhe në Kosovë, sidomos pas shpalljes së pavarësisë dhe ndryshimit të statusit të saj nga të qënurit pjesë përbërëse e ish-Jugosllavisë dhe regjimit okupues të Milosevicit në një shtet të pavarur dhe demokratik u shpreh nevoja për formimin e një agjencie e cila do merret me parandalimin e gjithë këtyre dhe të tjerëve faktorë negative që dobësojnë sigurinë shtetërore.

Shërbimi inteligjent mund të konsiderohet si vija e parë e padukshme e frontit me çka nënkuptojmë që në rast të dështimit të saj, pra moszbulimit për të parandaluar ndonjë aksion potencial të fshehtë të organizuar nga ana e “armiqëve” të brendshëm apo të jashtëm, rolin e marrin të tjera institucione shtetërore të dukshme në mbrojtje të sigurisë vendore. Qëllimi kryesor i këtij punimi është përshkrimi i kontrollit demokratik mbi institucionet e shërbimit të inteligjencës, ku këtu përveq përfshirjes së institucioneve shtetërore siq janë qeveria, parlamenti, gjykatat, mediat, shoqëria civile që kanë rolin kryesor në veprimtarinë e agjencisë, përfshihet edhe roli i organizatave ndërkombëtare.

Vet titulli si i këtillë konsiston në analiza dhe marrjen për bazë të kontrollueshmërisë së shërbimeve të fsheta në vendet demokratike dhe në rastin konkret në Kosovë. Në këtë temë do të shtjellohet sëpari historiku i shërbimit të inteligjencës në përgjithësi duke filluar nga aspekti ndërkombëtar i shërbimeve të inteligjencës. Një rëndësi do ti kushtohet kornizës ligjore që rregullon shërbimet e inteligjencës. Fokusi qëndror në aspektin legjislativ është tek Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Klasifikimi i Informacioneve si dhe Leja e Sigurisë. Në këtë drejtim do të behët një analizë e këtij legjislacionit ekzistues që ka të bëjë me sektorin e sigurisë, pra të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Inteligjencës ku do të shpjegohet roli i agjencisë, detyrat dhe përgjegjësitë e saj, të drejtat e punonjësve, pastaj të Ligjit mbi Klasifikimin e të Dhënave dhe Verifikimin e Sigurisë ku do të shpjegohen nivelet e

informacioneve të klasifikuara, përgjegjësia e institucioneve kundrejt tyre si dhe procedura e dhënies së sigurisë zyrtarëve përgjegjës për zhvillimin e inteligjencës.

Pas bazes ligjore do të shpjegohet roli dhe rendësia e secilit institucion shtetëror dhe joshtetëror që kanë në mbikëqyrjen e veprimtarisë së shërbimit të inteligjencës, roli i saj në sigurinë e vendit dhe mbrojtja e saj nga faktorë të ndryshëm dhe çdo here më të panjohur për institucionet shtetërore. Edhe pse në këtë hulumtim do të ceket shkurtimisht roli i shërbimeve kryesore të inteligjencës në botë, prapëseprap fokusi kryesor do të qëndrojë tek shërbimi inteligjent në Kosovë. Do të behët një krahasim me të kaluarën duke cekur gjitha shërbimet sekrete që kanë vepruar në Kosovë deri në vitin 2008, cilat veprojnë tani dhe niveli i mbikëqyrjes së tyre nga institucionet relevante shtetërore. Nga vlerësimet e bëra duke analizuar shërbimet e inteligjencës në botë, historikun e këtyre shërbimeve, kornizen ligjore dhe të tjera çështjeve të lidhura me këto, do të paraqiten disa të gjetura në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Në fund do të listohen një sërë rekomandimesh të cilat do të u drejtohen në mënyrë specifike secilit institucion që ka rol në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, duke shpresuar që në të ardhmen e afërt ato të merren parasysh nga organët përgjegjëse.

3. METODOLOGJIA E PËRDORUR/VËSHIRËSITË

Metodologjia e përdorur për të draftuar këtë temë të diplomes është e bazuar kryesisht në hulumtim kualitativ (vlerësimi i kornizes ligjore, raporteve, artikujve të gazetave ditore, internet, observimi i zhvillimeve në këtë fushë). Një rendësi të veçantë kanë edhe intervistat me akterët kyq të sektorit të sigurisë në Kosovë. Poashtu ka pasur edhe të dhëna nga hulumtuesit e Qendres Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) të cilët kanë ndarë përvojën e tyre dhe njohuritë në sektorin e sigurisë në përgjithësi, e në veçanti në temën e shtjelluar. Kjo temë diplome ka për qëllim të bëjë një analizë të shkurtër akademike dhe është e fokusuar që të shërbejë si material bazë për të informuar publikun e gjerë, ku në radhë të parë përfshihen studentët që merren me studime të sigurisë apo të shkencave politike për rolin e shërbimeve inteligjente, kornizën e tyre ligjore, mbikëqyrjen nga institucionet shtetërore, mangësitë e hasura deri në këtë fazë në AKI e të tjera çështje që kanë të bëjnë me sektorin e sigurisë së shtetit e në veçanti shërbimet e inteligjencës me fokus qendror në shërbimin inteligjencë në Kosovë.

Vështirësi ka pasur kryesisht në grumbullimin e materialit për faktin që është një prej sferave më jotransparente në një shtet e sidomos në Kosovë. Ky institucion i Kosovës nuk posedon as edhe një faqe të internetit apo ndonjë raport për progresin e arritur deri me tani. Duhet theksuar edhe faktin që është njëra prej fushave mjaftë të reja në Kosovë dhe vërehet mungesë ekspertize të duhur në këtë fushë, ku mund të ceket edhe fakti që as edhe një raport, punim akademik, vlerësim analitik apo ndonjë analizë e historikut për shërbimin inteligjent në Kosovë nuk ekziston. Prandaj njëri prej qëllimeve për punimin e kësaj teme të diplomes është që sado pak të thejë mungesën e informacioneve të kësaj fushe.

4. ROLI I SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS NË SIGURINË KOMBËTARE

Duke u nisur nga fakti që “spiunazhi” ka qenë njëri prej profesioneve më të vjetra në botë dhe nga ajo kohë ka egzistuar nevoja për të pasur informacion, egziston një dallim qenësor i shërbimit inteligjent të mëhershëm me atë të kohës së tanishme. Në radhë të parë mund të theksohet teknologjia dhe mjetet tjera të grumbullimit të informacionit të cilat në kohën e mëhershme nuk kanë qenë aspak të volitshme duke imponuar kështu nevojën e një kohë më të gjatë për një informacion i cili duke u bazuar nga mjetet të cilat përdorëshin për grumbullimin dhe përpunimin e tij jo çdo here do mund të ishte edhe i sakte.

Termi Inteligjencë nënkupton në të shumtën e rasteve mbledhjen e fshehtë të informacionit ku me tu përcaktuar nevojat fillon edhe procesi i grumbullimit, analizimit, prodhimit dhe përdorimit të informacioneve rreth shteteve, grupeve, individëve apo aktiviteteve potencialisht të rrezikshme në mënyrë që pastaj vendimmarrësit të marrin vendime të sakta rreth politikave shtetërore.¹

Njëra prej shkencave që ka impakt të madh në shërbimet e inteligjencës dhe në veçanti në atë që ka të bëjë me grumbullimin e informacionit është Kibernetika e zhvilluar që nga viti 1947 e cila është fjalë greke dhe që ka kuptimin drejtues, me prejardhje nga disiplinat tjera si biologjia, matematika, inxhinieria elektrike e të tjera.² Ajo është shkenca e prapaveprimit – studimit të mënyres se si informacioni mund të ruajë ose të ndryshojë çdo sistem biologjik, social mekanik ose artificial.³

Në përgjithësi kombet e mëdha kanë pjesërisht apo plotësisht këto lloje të agjencive të inteligjencës:

¹ Collins, Alan (2007) Contemporary Security Studies, Oxford University Press, New York

² Collins, Alan (2007) Contemporary Security Studies, Oxford University Press, New York

³ Po aty

- Një zyre të përgjithshme mbikëqyrese ose një grup zyrash të ngarkuara me koordinimin e agjencive të ndryshme që formojnë komunitetin e inteligjencës së një vendi.
- Një agjenci përgjegjëse për grumbullimin, analizimin, përgatitjen dhe përdorimin e informacioneve të nxjerra nga vende të huaja dhe nga burime të jashtme.
- Një agjenci përgjegjëse për grumbullimin, analizimin, përgatitjen dhe përdorimin e informacioneve për kërcënime të brendshme të sigurisë.
- Një agjenci përgjegjëse për grumbullimin dhe shpërndarjen e inteligjencës së sinjaleve.
- Një agjenci që funksionon nën drejtimin e departamentit ushtarak ose të departamenteve të një qeverie për të garantuar inteligjencën e nevojshme për forcat ushtarake.

Në varësi të madhësisë dhe përfshirjes globale, kombet mund të kenë agjenci të ngarkuara në mënyrë specifike me antiterrorizmin, zhvillimin, operimin dhe shfrytëzimin e imazheve satelitore dhe mbitokësore; kunderinteligjencën; mbrojtjen e kufinjëve si dhe funksione të tjera specializuara.⁴

4.1. Metodatat e Grumbullimit të Informacionit

Ekzistojnë dy metoda të përgjithshme për grumbullimin e informacionit të cilat ndryshe quhen disiplina të inteligjencës siq janë:

1. Grumbullimi i inteligjencës njerëzore (humint) dhe
2. Grumbullimi i inteligjencës teknike (techint)

Inteligjenca njerëzore – është njëra prej disiplinave më të vjetra ku pavarësisht mënyrave dhe metodave të ndryshme që përdornin spiunet në periudha të ndryshme kohore, qëllimi i tyre siq e cekë Alan Collins në librin e tij “Studime Bashkëkohore të Sigurisë” ka qenë përherë i njëjtë: përfitimi i avantazhit kundrejt një komponenti duke depërtuar nëpër sekretet e tij.

⁴ Collins, Alan (2007) Contemporary Security Studies, Oxford University Press, New York

Inteligjenca teknike – deri në Luften e Parë Botërore termi inteligjencë teknike është përdorur për ti'u referuar armëve dhe sistemeve të armatimit, kurse tani i ky term i referohet të gjitha mjeteve teknike të cilat shërbejnë për grumbullimin e informacioneve. Edhe pse zbulimi i mjeteve të reja të komunikimit e lehtësoi dukshëm procesin e shkëmbimit dhe grumbullimit të infomatave, ai poashtu kishte një të metë që do ta dobësonte atë e që është lehtësia e përgjimit të kanaleve të komunikimit. Këtu vlenë të përmendet edhe përdorimi në masë të gjërë i aftësive sigint (inteligjenca e sinjaleve) që mund të ndahen në: sigint, masint, comint, radint dhe elint.⁵

4.2. Disiplinat e Grumbullimit të Informacionit

Humint – Inteligjenca njerëzore: informacion i mbledhur nga zyrtarët e inteligjencës.

Technit – Inteligjenca teknike: fillimisht i është referuar sistemit të armatimit, kurse në kohën bashkohore i referohet përdorimit të të gjitha mjeteve teknike që ndikojnë në grumbullimin e informacionit.

Sigint – Inteligjenca e sinjaleve: i referohet grumbullimit të informacioneve me anë të aparateve të ndryshme elektronike.

Imint – Inteligjenca e Imazhit: i referohet grumbullimit të imazheve fotografike dhe dixhitale nga sisteme orbitale (satelitë), atyre me bazë tokësore (mjeteve ajrore të pakomanduara, aeroplanëve).

Photint – Inteligjenca fotografike: përdoret për të përshkruar fotografitë në film dhe ato dixhitale të marra nga satelitët.

Comint – Inteligjencia e komunikimeve: interceptimi i komunikimeve midis dy ose më shumë palëve.

Telint – Inteligjenca telemetrike (largësimatëse): interceptimi i të dhënave të transmetuara gjatë testimit të llojeve të ndryshme të sistemeve të armatimit.

Elint – Inteligjenca elektronike: interceptimi i dërgesave elektronike të lëshuara prej armëve dhe sistemeve të gjurmimit.

⁵ Collins, Alan (2007) Contemporary Security Studies, Oxford University Press, New York

Masint – Inteligjenca e masave dhe nënshkrimeve: me qka nënkuptohet përdorimi i mjeteve të sofistikuara të cilat shërbejnë për identifikimin e materialeve të përdorura në lloje të ndryshme të armeve moderne.

Radint – nënkupton informacionin që buron nga përdorimi i sinjaleve të radarëve të lëshuar prej satelitëve orbitalë, avionëve ose burimeve me bazë tokësore.

Osint – Inteligjenca e burimit të hapur: grumbullimi i informacionit nga një sere burimesh që janë publikisht të disponueshme të tilla si mediat, informacioni qeveritar, publikime të ndryshme akademike e të tjera.⁶

4.3. Procesi (cikli) aktiviteteve në Inteligjencës

Ekzistojnë disa etapa të cilat e karakterizojnë procesin e inteligjencës dhe praktikohen në shumicën e shtetëve demokratike. Ky proces përbehet nga këto etapa të bërjes së inteligjencës:

Etapa e vendosjes së prioriteteve: Njohja rreth shteteve, nevoja për të ditur punet dhe veprimet e personave dhe shtetit tjetër, vendosja e mënyres së grumbullimit të informacioneve të nevojshme.

Etapa e grumbullimit: Grumbullimi i informacionit duke përdorur disiplinat e inteligjencës, sidomos atë humint, techint dhe osint.

Etapa e përpunimit: përkthimi i materialeve në gjuhët e huaja, çkodimi i komunikimeve të koduara, si dhe interpretimi i fotografive.

Etapa e analizës: ku i gjithë informacioni i grumbulluar i pasohet analistëve të cilët duhet të ndajnë informacionin e vlefshëm nga ai që nuk qon peshë, të mundojnë ta shpjegojnë atë në kontekstin historik. Ku pas kësaj etape të analizës i gjithë informacioni për dallim nga ai që ishte deri në shkallën e përpunimit e që quhet Inteligjencë e papërpunuar, ky lloj informacioni në këtë stad quhet inteligjencë e përpunuar.

Etapa e prodhimit: në këtë fazë inteligjenca e përpunuar mund të marrë formë të ndryshme duke u varur nga vendimmarrësit dhe kërkesat. Në këtë fazë pra përcaktohet niveli i

⁶ Collins, Alan (2007) Contemporary Security Studies, Oxford University Press, New York

urgjencës, edhe pse në raste të veçanta dhe në kohë të ndjeshme informacioni i dërgohet menjëherë vendimmarrësve.

Etapa e përmbylljes: dorëzimi i informacionit tek ata që e kërkuan atë në fillim, pra zyrtarët e lartë qeveritar.

5. HISTORIKU I SHËRBIMIT TË INTELIGJENCËS NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

Historianët me shekuj debatojnë zhvillimin dhe rendësinë e shërbimeve të inteligjencës si dhe rolin e tyre në shërbim të qytetarëve. Në momente të caktuara këndvështimet për shërbime të inteligjencës kanë qenë të ndryshme varësisht nga rrethanat në të cilat ato kanë vepruar. Thuhet se spiunazhi është profesioni i dytë më i vjetër në botë.⁷ Detyra kryesore e agjentëve ishte zbulimi i armiqëve të tyre por, ndonjëherë këto agjensi kishin për qëllim edhe identifikimin e miqëve. Në fakt shetet dhe shoqëritë në përgjithësi i kanë kushtuar rëndësi të posaçme identifikimit të kërcënimeve dhe rreziqeve që i kanosen si nga jasht, po ashtu edhe ato të brendshme. Një gjë të tillë e mbështetë edhe konstatimi i filozofit kinez Sun Tzu në thenien e tij të famshme “Ai që njeh kundërshtarin e vet dhe veten, nuk do njohë rrezikun as në njëqind lufta”. Jo çdo herë kërcënimet dhe rreziqet kanë ardhur nga një popull, grup apo individ i një shteti tjetër. Ato fatkeqësisht shpesh janë shkaktuar edhe si rezultat i faktorëve të ndryshëm brenda për brenda shoqërive të caktuara. Një gjë e tillë është evidente sidomos në kohët e sotme. Në këtë drejtim vlen të theksohet se zbulimi i kërcënimeve dhe rreziqeve në kohët e mëhershme shumë më e lehtë realizohej në krahasim me kohën e sotme. Me gjithë zhvillimin teknologjik që mundëson lehtësimin e zbulimit të pothuajse çfarëdo akti kriminal apo të ngjashme, një gjë e tillë ka mundësuar po ashtu edhe shkathtësitë në kryerjen e veprimeve të caktuara nga individët apo grupet kriminale, terroriste, spiunët dhe të tjerë duke ju mundësuar të zhvillojnë ‘veprimtaritë’ e tyre pa u dikuar.

Historikisht shërbimet e inteligjencës kanë zhvilluar operacionet e tyre në mënyrë të fshehtë dhe kryesisht janë kontrolluar nga një numër i vogël zyrtarësh qeveritar. Në Bashkimin Sovjetik dhe Gjermaninë naziste shërbimi i inteligjencës qëndronte mbi ligjin, kurse në botën bashkëkohore vetëm shërbimet e ShBA-ve, Mbretërisë së Bashkuar dhe Rusisë mund të kenë aktivitete globale.⁸ Për herë të parë në vitin 1976 ShBA-të vendosen nën mbikëqyrje të përhershme komunitetin e sigurisë. E njëjta mund të thuhet edhe për nivelin e mbikëqyrjes i

⁷ The world of Secret Services, <http://www.topspysecrets.com/secret-services.html> Shtator, 2010

⁸ Collins, Alan (2007) Contemporary Security Studies, Oxford University Press, New York

cili dallon prej shtetit në shtet, ku psh. ShBA ka kontrollin më të gjerë përderisa Rusia mbikëqyrjen më të reduktuar. Edhe pse në këtë drejtim ekziston një rritje e vazhdueshme për mbikëqyrjen e shërbimeve dhe operacioneve inteligjente nga ana e legjislativit, në shtetet demokratike ende disa degë të catuara të disa shërbimeve inteligjente vazhdojnë të operojnë vetëm nën kontrollin e ekzekutivit.⁹ Në fund të shekullit të XX u jepen autorizimet statusore shërbimeve të inteligjencës duke u vendosur në shkallë të mbikëqyrës legjislative. Prej të gjitha shërbimeve që ekzistojnë në botë, vetëm shërbimet inteligjente të ShBA-ve, Mbretërisë së Bashkuar dhe Rosisë mund të konsiderohen globale për nga aftësitë operative dhe struktura, kurse shumica prej të tjerave kanë interesa rajonale dhe aftësi operative më të kufizuara.¹⁰

5.1. Shembuj të Shërbimeve të Inteligjencës në Botë

5.1.1. Shërbimet Inteligjente në ShBA

Në ShBA roli i shërbimeve inteligjente ka evoluar në mënyrë dramatike që nga koha e formimit të tyre. Vlenë të ceket që në fillim detyra e agjencisë ishte të ndikojë në zhdukjen e falsifikimit të faturave në kohën kur një nga tri fatura ishin falso. Rasti i vrasjes së presidentit Abraham Lincoln në një mënyrë a tjetër ka përcaktuar edhe shërbimin sekret të Shteteve të Bashkuara. Edhe pse këtij shërbimi i është caktuar detyra për mbrojtjen e presidentëve dhe familjeve të tyre, kjo siguri presidenciale është bërë detyrë e zyrtarizuar vetëm pas vitit 1901, pra pas vrasjes së presidentit që qeveriste në atë kohë. Mirëpo vetëm pas përpjekjes së deshtuar për të vrarë presidentin që ushtronte detyrën gjatë vitit 1951 Kongresi kodifikoi rolin e përhershëm të agjencisë në mbrojtjen e Familjes së Parë.¹¹ Kjo përgjegjësi është zgjeruar edhe kundrejt zyrtarëve të lartë shtetëror dhe personaliteteve të rëndësishme në ShBA.

CIA – *Agjencia Qendore e Inteligjencës* është agjencia kryesore e shërbimit inteligjent në ShBA e krijuar në vitin 1947 që ka mision të mbledhë dhe vlerësoj inteligjencën e jashtme. Ajo është pasardhëse e OSS – Zyra për Shërbime Strategjike e cila ishte agjenci ushtarake e

⁹ Po aty

¹⁰ Po aty

¹¹ A Brief History of: The Secret Service, <http://www.time.com/time/magazine/article/0,9171,1860895,00.html>

krijuar gjatë Luftes së Dytë Botërore.¹² Ajo koordinon aktivitetet inteligjente, vlerësimin dhe shpërndarjen e inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë nacionale.¹³ Në fazen fillestare të krijimit të agjencisë, ajo gëzonte pavarësi të tepruar dhe institucionet tjera shtetërore kishin kontroll të limituar mbi funksionimin e saj. Pas gjetjeve të disa keqbërjeve të agjencisë, pozita e saj ka ardhur duke u degraduar, dhe ndryshuar nga viti 1970, derisa i është ndaluar spiunimi brenda ShBA-së. Mirëpo shumë restriksione më vonë i janë hequr pas sulmit të 11 Shtatorit të vitit 2001.¹⁴

Një tjetër agjenci e shërbimit inteligjent në ShBA është edhe FBI – *Zyra Federale e Investigimit*, që merret me krime të caktuara brenda ShBA. Ajo konsiderohet si armë e investigimit të Departamentit të Drejtësisë në ShBA.¹⁵

Një agjenci tjetër me rendësi në ShBA është edhe NSA – *Agjencia Nacionale e Sigurisë*. Ajo poashtu është agjenci e shërbimit inteligjent nën Departamentin e Mbrojtjes e cila merret me mbledhjen e të dhënave në komunikimet me jashtë dhe analizimin e komunikimeve në mes të Amerikës dhe agjencive tjera.¹⁶ Ajo është njera prej shërbimeve më sekrete në botë. Për shumë vite me radhë as vet qeveria e ShBA-ve nuk njihje ekzistimin e saj. Ajo është agjencia më e madhe në ShBA dhe përdorë teknologji më të avancuar kundërsht gjitha organizatave tjera.¹⁷

5.1.2. Shërbimi Inteligjent i Rusisë

KGB – *Komiteti Shtetëror i Sigurisë* ka qënë ombrellë e BRSS deri në vitin 1991. Ishte krijuar në vitin 1917 pas luftes civile dhe quhej Cheka.¹⁸ KGB ka pësuar shumë ndryshime në emërtime dhe funksione, mirëpo njera prej detyrave primare të KGB-së përpos tjerash ishte eliminimi nga shteti i të gjitha organizatave që vepronin kundër BRSS dhe mbrojtja e liderëve të partisë komuniste. Ka qënë shumë e centralizuar dhe posedonte departamente të saja në të gjitha qendrat e mbrojtjes në Rusi. Agjentët e KGB-së monitoronin mendimet politike në Rusi dhe kontrollonin nëse masat e sigurisë ishin në standardet e duhura. Numri i punonjësve dhe buxheti asnjëherë nuk ishin saktë të ditura duke marrë parasysh që kishte natyrë të fshtetë. Përderisa shërbimet e inteligjencës perendimore i kushtonin rendësi më të madhe përgjimit elektronik, Rusia i kushtonte rendësi kryesisht inteligjencës njerëzore. Duhet cekur se një

¹² The History of CIA, <http://www.topspysecrets.com/central-intelligence-agency.html> Shtator 2010

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

¹⁵ FBI - Federal Bureau of Investigation, <http://www.topspysecrets.com/federal-bureau-of-investigation.html>

¹⁶ NSA - National Security Agency, <http://www.topspysecrets.com/national-security-agency.html> Shtator, 2010

¹⁷ Po aty

¹⁸ The Russian KGB, <http://www.topspysecrets.com/russian-kgb.html> Shtator, 2010

sukses në këtë aspekt Rusia e ka arritur në Angli, duke rekrutuar njerëz në pozita të rëndësishme që punonin për interesa të Rusisë. Kjo më vonë rezultoi në përjashtimin e mbi 100 zyrtarëve të ambasadës sovjetike në Angli shkak i dyshimit për spiunazh.¹⁹

5.1.3. Shërbimet Inteligjente në Mbretërinë e Bashkuar

MI5 – *Inteligjenca Ushtarake, Seksioni 5* është agjenci britaneze e sigurisë dhe e kundër inteligjencës. Është e themeluar që nga viti 1909 përgjegjëse për luftimin e terrorizmit, militantizmit, spiunazhit dhe aktiviteteve kriminale brenda Britanisë së Madhe.²⁰ Pra, është e koncentruar vetëm për sigurinë e brendshme të Britanisë, ekonominë dhe demokracinë parlamentare duke asistuar qeverinë dhe partitë relevante të Britanisë në çështjet e sigurisë.

MI6 – *Inteligjenca Ushtarake Seksioni 6* e njohur edhe si *Shërbimi Sekret Informativ (SIS)* është përgjegjëse për çështjet e sigurisë së jashtme të Britanisë së Madhe duke u mbështetur kryesisht në teknologjinë më të re.²¹

5.1.4. Shërbimi Inteligjent Izraelit

Një tjetër shërbim i fshehtë që vlenë të përmendët është Mossad i Izraelit përndryshe *Instituti për Inteligjencë dhe Operacione Speciale*. Bahkëpunon me të tjera shërbime inteligjente të Izraelit siq është Shabak (Siguria e Brendshme) dhe AMAN (Inteligjenca Ushtarake).²² Mossad është organizatë civile e cila mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e spiunazhit që kanë të bëjnë me sigurinë e Izraelit. Zyrtarët e Mossaid nuk marrin gradë ushtarake, megjithatë shumica e anëtarëve të Mossaid janë ish-pjesëtarë të Forcave të Mbrojtjes së Izraelit. Është i ngjashëm me MI6 Britaneze dhe CIA Amerikane dhe është nën kontroll të kryeministrit Izraelit. Poashtu kryen operacione të fshehta dhe ato paramilitare, kundër inteligjencë dhe aktivitete kundër terrorizmit.

¹⁹ KGB recruitment successes <http://www.topspysecrets.com/kgb-recruitment-success.html> Shtator, 2010

²⁰ The History of Military Intelligence 5 <http://www.topspysecrets.com/mi5-history.html> Shtator, 2010

²¹ MI6 Military Intelligence 6 <http://www.topspysecrets.com/mi6-military-intelligence.html> Shtator, 2010

²² The Israeli Mossad <http://www.topspysecrets.com/israeli-mossad.html> Shtator, 2010

6. ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE INTELIGJENTE NE KOSOVË DERI NË VITIN 2008

Kuptohet që zhvillimi i shërbimeve të inteligjencës në Kosovë në krahasim me atë të shteteve tjera është më i vonshëm. Njëra prej arsyeve që shpjen në këtë konkludim mund të thuhet të jenë rrethanat historike dhe pozita së saj në kuadër të ish-Jugosllavisë. Shërbimi inteligjent i Kosovës përkon më tepër nga ai i shërbimit inteligjent anglez. Në Kosovë nga koha e pasluftes ishin prezente shumë shërbime të huaja të fshehta duke përfshirë atë të UNMIK-ut dhe KFOR-it, shërbime të fshehta të krijuara nga serbët të cilet punonin për interesa të Serbisë dhe kundër Kosovës. Në fazën në të cilën gjindet aktualisht Kosova, shërbimi i inteligjencës është njëra prej fushave të cilës nuk i është kushtuar dhe nuk po i kushtohet rëndësia e merituar për shkak të ndoshta edhe krizave të njëpasnjëshme politike që kanë qënë prezente pothuajse gjatë gjithë kohës. Për dallim prej Kosovës, Britania e Madhe e cila ka një shërbim të inteligjencës që daton nga viti 1909²³ që është njëra prej agjencive më të vjetra të botes në këtë fushë, përderisa Amerika ka Agjencinë e Sigurisë Shtetërore dhe Agjencinë Qendrore të Inteligjencës që daton prej vitit 1951 konkretisht 1949.²⁴ Pra, Kosova si shteti më i ri për momentin ka institucionet më të reja dhe njëherit shërbimin më të ri inteligjent në botë dhe si i tillë është i nivelit jo të dëshiruar. Në nënkapitujt më poshtë do të elaborohen shërbimet e fshehta që vepronin në Kosovë në periudha të ndryshme kohore, rolin që ato kishin dhe aktivitetet që ushtronin ndaj “sigurisë kombëtare”.

6.1. Shërbimet e inteligjencës deri në periudhën e vitit 1999

Një ndër formacionet e para të cilësuar si shërbime të inteligjencës në Kosovë ishte e ashtuquajtura Uprava Drzavne Bezbednosti – UDBA (Drejtoria e Sigurisë Shtetërore). Drejtoria e Sigurisë Shtetërore ishte organizatë e policisë sekrete të Republikës Socialiste

²³ <http://www.sis.gov.uk/output/history-of-sis.html> Shtator, 2010

²⁴ <http://www.nsa.gov/index.shtml> Shtator, 2010

Federale të Jugosllavisë (RSFJ). Ajo është themeluar dhe funksiononte nga viti 1946 deri me 1991 që fillimisht ishte përgjegjëse për sigurinë e brendshme shtetërore. Si të gjitha regjimet Komuniste edhe në Jugosllavi nevojitej një shërbim i cili do të mbështeste pushtetin totalitar ekzistues nga gjithë ata të cilët mendonin ndryshe, e të cilët në këtë kohë trajtoheshin si armiq të kombit. Në këtë drejtim janë të panumërta rastet e arrestimeve, vrasjeve misterioze, përndjekjet politike e të tjera, të ndërmarra nga UDBA. Kjo vërehej sidomos tek popullata shqiptare e Kosovës e cila ishte krejtësisht e pakënaqur me trajtimin që i bëhej në kuadër të federatës dhe në raste të caktuara atdhetarë të ndryshëm madje nuk nguronin ti shprehnin hapur padrejtësitë e shkaktuara.

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe privimit të statusit autonom të Kosovës, qytetarët e Kosovës ballafaqoheshin me një trajtë tjetër të regjimit diktatorial. Nga kjo kohë shërbimet e inteligjencës vepronin jo për të mbrojtur ideologjinë e atëhershme Komuniste të cilën e kultivonte Jugosllavija e atëhershme, për të cilën UDBA ishte vënë në funksion deri në këtë periudhë, por për ti për ta përkrahur ideologjinë nacionaliste që doli në pah me ardhjen në pushtet të Milosevicit. Janë të panumërta rastet ku shërbimet sekrete policore hetuan, përgjuan, përndjekën dhe eliminuan veprimtar të ndryshëm por edhe qytetarë të thjeshtë të cilët nuk patën fare gisht në veprimtaritë për të cilët ata akuzoheshin.

6.2. Shërbimet e Inteligjencës deri në periudhen e vitit 2008

Në Kosovë nga viti 1999 vepronte *Shërbimi Inteligent i Kosovës* (ShIK) i cili është formuar në vitin 1998 si departamenti i Ushtrisë Qilirimtare të Kosovës (UQK-së). Ky shërbim konsiderohet si një shërbim joprofesional, që punonte për të parandaluar rreziqet kunder UQK-së, dhe për më tepër i krijuar për interesa personale të partive politike siq është Partia Demokratike e Kosovës (PDK). ShIK-u nuk ka ndonjë imazh të mire as në vend dhe as nga komuniteti ndërkombëtar, pasi që procesi i veprimit të ShIK-ut ka qenë plotësisht jotransparent. Dyshohet që ShIK-u të jenë financuar në baza kriminale apo edhe janë paguar për informacionet që ia kanë transmetuar shërbimeve të jashtme të inteligjencës. Poashtu nuk ka në dispozicion as edhe një dokument të vetëm lidhur me aktivitetet e ShIK-ut dhe dyshohet që mund të ekzistojë ndonjë.²⁵ ShIK-u ka bashkëpunuar me shërbimet inteligjente përëndimore e sidomos me Ameriken, të cilat shërbime përpos që i kanë ofruar instruksione

²⁵ Intervistë e zhvilluar me një ekspert të pavarur në Kosovë, Shtator, 2010

dhe trajnime, ato njekohësisht e kanë financuar atë. Bashkëpunimi i shërbimeve inteligjente perëndimore me ShIK-un ishte më tepër për shkak të sigurisë globale ku ndërkombëtarët kanë pasur drojë se në Kosovë mund të penetrojnë për shumë arsye aktivistë të fundamentalizmit islamik. Ngjashëm më këtë ishte edhe Shërbimi i Fshehtë Informativ i LDK – *Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Opinion Publik* që merrej me mbledhjen e informacionit për qëllime të partisë dhe dyshohet që ky shërbim i inteligjencës përbehej nga ish-luftetarët e luftes të vitit 1999.

Përpos shërbimeve të lartpërmendura ekzistonin edhe të tjera shërbime të fshehta ilegale që vepronin në Kosovë të formuara nga serbët. Në vitin 2003, ndërkombëtarët në Gjenevë përmes disa organizatave botërore kishin paralajmëruar për praninë e madhe të armëve ilegale, të futura në Kosovë nga veriu i Mitrovicës. Futja e këtyre armëve ka bërë që në Kosovë të kishte shumë vrasje dhe incidente kundër popullatës civile, ndërkombëtarëve dhe sulme të tjera me granata kunder institucioneve policore. Në Mitrovicën veriore vepronte mafia dhe bandat e ndryshme kriminale serbe të cilat kishin për qëllim destabilizimin e terësishëm të Kosovës. Konsiderohej se rendin dhe ligjin në veri të Mitrovicës e mbanin strukturat ilegale dhe paramilitare siq ishin: *Rojat e Urës, Dora e Zezë, Armata Çlirimtare (OSA), Shqiponjat e Bardha* etj.²⁶ Këto banda ka mundësi të kenë operuar deri vonë apo edhe operojnë edhe sot në brendi të territorit të vendit me qëllim që të ndikojnë në destabilizimin e situatës në Kosovë. Për funksionimin e strukturave të ndryshme serbe në Kosovë ishte pranuar edhe nga shefi i atëhershëm i sigurimit serb, Momir Stojanovic. Veprimi i Shërbimeve të Huaja të Inteligjencës – një tjetër rol kishin edhe zyret ndërkombëtare të vendosura në Kosovë. Sikur roli i Ambasadave shtetërore në vendet e dyta që është kryesisht për mbledhjen e informacioneve dhe rrjedhave në shtetin pritës, poashtu edhe roli i këtyre zyreve ndërkombëtare ishte mbledhja e inteligjencës për rrjedhojat dhe zhvillimet në Kosovë.

Duhet cekur një element që ka karakterizuar gjithë këtë proces dhe zhvillim në këtë sferë që kishte të bente me kontrollimin dhe mbikëqyrjen e këtyre shërbimeve të fshehta. Kishte një mungesë të kontrollit demokratik në mbikëqyrjen e këtyre shërbimeve të fshehta që kryesisht vepronin për interesa personale dhe asnjëherë për mbrojtjen e sigurisë së Kosovës. Kjo gjë në të vërtetë ka ndikuar në dobësimin e mundësisë së kontrollit të Kosovës ndaj këtyre shërbimeve dhe në dobësimin e sigurisë në vend duke e bërë atë një vend ku mjaftë lehtë mund të zhvillohej kontrabanda, krimi i organizuar dhe të tjera dukuri negative që kanë

²⁶<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:jJp60sjvY5UJ:www.gazeta55.al/gazeta/07.07.2010.p df+rojat+e+ures+ne+veri+te+mitrovices+pdf&cd=6&hl=en&ct=clnk&source=www.google.com> Korrik, 2010

ndikuar në dobësimin e imazhit të përgjithshëm të Kosovës dhe popullsisë së saj. Mungesa e ligjeve që rregullojnë këto shërbime ka qënë kryesisht në dëm të qytetarit dhe integritetit duke ndikuar në mundësinë e keqpërdorimit të dhënave personale të tyre, gjë që rezultonte në një doze të konsiderueshme të mosbesimit nga ana e qytetarit ndaj qeverisë.

7. KRIJIMI I AGENCISË SË KOSOVËS PËR INTELIGJENCË – 2008

Konform fillimit të negociatave mes Sërbisë dhe Kosovës me ndërmjetësim ndërkombëtar, me vendim të institucioneve të Kosovës në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar, nga fundi i vitit 2005 dhe fillimi i vitit 2006 filluan përgatitjet e infrastrukturës së shërbimit të parë inteligjent legjitim në Kosovë.²⁷ Në bazë të ligjit janë shuar të gjitha shërbimet sekrete që vepronin në Kosovë siq është ShIK-u, shërbimi sekret i PDK-së si, ai i LDK (Sigurimi i Atdheut) e të tjera. Krijimi i Agjencisë Kosovare për Inteligjencë ka qënë i doemosdoshëm për faktin që deri në këtë kohë vepronin me dhjetra shërbime sekrete të huaja dhe vendore në Kosovë që nuk ishin profesionale dhe aq më pak kishin mbështetje ligjore. Poashtu me rezoluten 1244 nuk lejohej krijimi i asnjë shërbimi inteligjent dhe kjo për shkaqe politike, pasi agjencia është pra njëra prej shtyllave shtetërore. Edhe pse në AKI ka mjaftë hapsirë për përmirësime, megjithatë një përparësi e kësaj agjencie kundrejt institucioneve tjera të Kosovës është fakti që ajo ka filluar të veprojë edhe në veri të vendit, përkatësisht në pjesën veriore të Mitrovicës ku institucionet e Kosovës ende nuk e kanë shtrirë autoritetin e tyre.²⁸ Në nënkapitujt e mëposhtëm do të shtjellohen disa elemente të cilat e rregullojnë fushëveprimin e kësaj agjencie, strukturën e saj dhe të tjera çështje që janë jetike për legjitimitetin dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit të këtij shërbimi.

7.1. Infrastruktura Ligjore – Për të pasur një pikëpamje më të qartë lidhur me shërbimin e inteligjences, menyren e saj të veprimit, përsonat dhe institucionet përgjegjëse, të drejtat dhe

²⁷SHIK-u 1999-2008, rrethanat e veprimit dhe përfundimi i misionit, <http://www.tvkoha.tv/6109/shik-u-1999-2008-rrethanat-e-veprimit-dhe-perfundimi-i-misionit.html> Korrik, 2010

²⁸ Gazeta Zeri, <http://www.zeri.info/> 2010

obligimet si dhe në përgjithësi infrastrukturen ligjore të shërbimeve të inteligjencës do të bejmë një përshkrim të shkurtër të baze ligjore me theks të veçantë të Agjencionit Kosovar të Inteligjencës.

Krijimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI) është i rregulluar me Kushtetutë, por edhe me Ligjin mbi Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë të miratuar me 21 Maj të vitit 2008, pra në të njëjtin vit kur Kosova shpalli pavarësinë e saj. Infrastruktura ligjore e këtij lloji shërbimi shërben si mjet për përfortimin e rolit të agjencisë dhe detyrave të saj, për përcaktimin e qartë të përgjegjësisë si dhe fushen e veprimit të tyre për të arritur deri te qëllimi kryesor që është sigurimi i shtetit. Ekzistenca e një ligji që përcakton qartë aspektet e sigurisë kombëtare kontribuon kështu për të mbrojtur një vend kundër politizimit dhe shpërdorimeve të plota të shërbimeve të tij të fshehta të informacionit, gjë që paraqet njërin prej problemeve kryesore në shoqëritë demokratike në kohërat e tanishme. Si detyrë kryesore e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë si person juridik dhe me mandat në tërë territorin e Kosovës është që duke përdorur mjete të ligjshme të mbledhë, analizojë dhe shpërndajë informata që janë esenciale për mbrojtjen e sigurisë shtetërore.²⁹ Për të avancuar aktivitetet e saj, ajo e ka mundësinë e mbledhjes së informacioneve ku përfshihen: përgjime të ndryshme duke filluar nga ato teknike siq janë paisjet për dëgjim, përgjim dhe përcjellje, e deri tek personeli i fshehtë për mbledhjen e informacionit, agjentet e fshehtë si dhe mbledhja e të dhënave konfidenciale nga bankat, portet dhe telefoni³⁰. Mirëpo ky rast është përjashtim për personat që gëzojnë imunitet dhe privilegje të tjera diplomatike, përveq rasteve kur synohet parandalimi i kërcënimeve ndaj këtyre organeve, me ç'rast pastaj është obligim i drejtorit të AKI-së të informojë krerët e këtyre organëve apo organizatave për të gjitha llojet e kërcënimeve të tilla. AKI nuk ka funksione ekzekutive me të çka nënkuptohet që ajo nuk mund të përdorë forcë direkte apo indirekte; çfarëdo autoriteti për arrest; mundësinë të iniciojë procedura penale dhe nuk mund të detyrojë persona apo kompani të bashkëpunojnë për aktivitetet e saj. Në rast të shkaktimit të dëmeve të shkaktuara ndaj personave juridik apo fizik si rezultat i veprimeve të punonjësve të AKI-së të ndërmarra gjatë kryerjes së detyrave të AKI-së qeveria e mbanë përgjegjësinë kryesore. Ku ne këtë rast qeveria ka të drejtë të rikthejë çfarëdo shume të paguar në emer të kompensimit pales së tretë, nëse punonjësi i AKI-së shpallet përgjegjës për dëmet e shkatuara, nëse ato rezultojnë nga pakujdesia, nëse

²⁹ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

³⁰ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Fusha e veprimit

janë te qëllimshme dhe të paautorizuara.³¹ AKI-ja nëpërmjet mjeteve përkatëse mbronë sigurinë e aktiviteteve, informacionit, punonjësve dhe pronës, duke përfshirë këtu edhe verifikimin e kandidatëve, punonjësve dhe të kontraktuarve sipas nevojës. Ku të gjitha këto veprime kryhen me konfidencialitet, gjë që bëhet për mbrojtjen e sigurisë së vendit dhe popullit.³²

7.2. Struktura e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë përbëhet nga Drejtori, Zëvendësdrejtori, Inspektori i Përgjithshëm si dhe Punonjësit e Agjencisë.

7.2.1. Drejtori – Drejtori i AKI-së është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të AKI-së dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit të Kosovës. Ai ndihmohet nga zëvendësdrejtori, udhëheqësit e njësive organizative, këshilltarët dhe personeli me kualifikim të duhur sipas nevojës në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e parashtruara me Ligjin e AKI-së dhe Rregulloren e Organizimit të Brendshëm.³³ Ai emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri brenda 20 ditëve pune nga dita kur pozita mbetet e lirë, si dhe shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar. Ka një mandat pesë vjeçar i cili mund të vazhdohet edhe njëherë³⁴. Ai këshillon Presidentin dhe Kryeministrin për çështje të inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës, si dhe i njofton ata për punën e AKI-së. Është përgjegjës për mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informatave me kohë dhe pa u ndikuar nga arsytet politike. Mbron burimet e inteligjencës, informacionin e klasifikuar nga shpалosja e paautorizuar³⁵. Ka pushtet të emërojë punonjësit në AKI, vendos dhe koordinon marrëdhëniet me agjencitë e inteligjencës dhe sigurisë të qeverive të huaja për çështje që kanë të bëjnë me inteligjencën. Siguron që AKI-ja të mos ndërmer asnjë veprim që dëmton interesat e cilitdo komuniteti, partie apo organizatë politike si dhe të mos ndikojë në procese politike, opinion public dhe media në Kosovë. Propozon buxhetin vjetor bazuar nga udhëzimet e Platformes Politike të Inteligjencës dhe Sigurisë

³¹ Po aty, Funksionet e ndaluara

³² Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

³³ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Organizimi

³⁴ Po aty

³⁵ Po aty

bashkë me mendimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përfshirje në buxhetin vjetor të Kosovës³⁶. Përgatitë raporte dhe propozon plane dhe programe të AKI-së, duke përfshirë mes tjerash Programin dhe Raportin Vjetor të Aktivitetit. Përgatitë propozimin e Platformës Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë dhe Inicion dhe nënshkruan Memorandume të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me institucione dhe organe tjera. Raporton para Komisionit mbikëqyrës parlamentar sipas kërkesës dhe përgjigjet ndaj ankesave të individëve që besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga ana e AKI-së.³⁷

7.2.2. Zëvendës drejtori – Zëvendës drejtori i AKI-së ndihmon drejtorin e AKI-së dhe drejton aktivitetet operacionale të njësive organizative të AKI-së nën mbikëqyrjen e drejtorit. Ai emërohet mbi baza të profesionalizmit dhe përvojës së dëshmuar dhe pa marr parasysh përkatësinë politike, për një mandat pesëvjeçar, cili mund të përtërihet dhe do të rrjedhë pavarësisht nga mandati i drejtorit të AKI-së. Edhe ai sikurse drejtori emërohet nga Presidenti dhe Kryeministri prej një afat prej njëzet ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lire, i cili shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.³⁸ Ai përkohësisht kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së gjatë mungesës apo paaftësisë së drejtorit. Në rast të paaftësisë së përhershme, zëvendës drejtori i AKI-së kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së deri në kohën kur zëvendësimi i Drejtorit të AKI-së emërohet në mënyrë formale.

7.2.3. Inspektori i Përgjithshëm – Një rol shumë të rëndësishëm e ka edhe Inspektori i Përgjithshëm i cili poashtu emërohet nga Presidenti dhe Kryeministri i Kosovës. Në rastin e Kosovës kjo mënyrë e emërimit të inspektorit është përparësi kundrejt disa shteteve në të cilat ai emërohet nga vet drejtori i agjencisë. Ky emërim në këtë mënyrë zvogëlon mundësinë e keqpërdorimit të pozitës nga ana e drejtorit të agjencisë apo edhe vet inspektorit. Ai ka një mandat katërvjeçar, që mund të përsëritet edhe për një mandat tjetër katërvjeçar dhe shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.³⁹

³⁶ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

³⁷ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

³⁸ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

³⁹ Po aty

Inspektori i përgjithshëm i raporton drejtpërdrejt kryeministrit dhe organit mbikëqyrës parlamentar të paktën çdo gjashtë muaj dhe me kërkesë specifike me shkrim të Komisionit Mbikëqyrës Parlamentar. Inspektori i përgjithshëm inspekton aktivitetet e AKI-së. Ndhmon drejtorin të jetë i informuar në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme për problemet potenciale në aktivitetet e AKI-së, me qëllim të promovimit të ekonomisë, efikasitetit dhe evitimit të çfarëdo shkeljeje ligjore.⁴⁰

Ai i rekomandon Drejtorit të AKI-së veprime korrektuese dhe monitoron progresin e secilit veprim korrektues të urdhëruar nga drejtori i AKI-së. Përgjegjësia e inspektorit të përgjithshëm përfshin auditimet financiare të aktiviteteve të AKI-së. Përveç drejtorit të AKI-së, rezultatet e këtyre auditimeve i vihen në dispozicion edhe kryeministrit. Inspektori i përgjithshëm ka të drejtë të marrë në pyetje Punonjësit e AKI-së dhe të ketë qasje në objektet dhe të dhënat e AKI-së sipas nevojës, me qëllim të hetimit, inspektimit apo auditimit të brendshëm kuptohet pas njoftimit të drejtorit të AKI-së. Drejtori i AKI-së mund t'i ndalojë inspektorit të përgjithshëm të iniciojë, kryejë apo përfundojë cilindo inspektim apo auditim nëse drejtori përcakton se është e nevojshme të mbrohen interesat vitale të sigurisë së Kosovës. Nëse drejtori ushtron këtë të drejtë, ai do t'ia raportojë këtë veprim kryeministrit dhe presidentit të Republikës së Kosovës brenda shtatë ditëve kalendarike. Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për ofrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm në AKI duke shqyrtuar aktivitetet e AKI-së, duke iniciuar inspektime, auditime dhe hetime, duke hetuar ankesat në lidhje me aktivitetet e AKI-së apo të bëra nga personat në Kosovë. Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për të mbështetur hetimet e Ombudspersonit të Kosovës. Nëse e miraton drejtori i AKI-së, inspektori i përgjithshëm bënë zgjedhjen e individëve për ta ndihmuar atë në kryerjen e funksioneve të veta, duke përfshirë individë të kualifikuar për të kryer auditime financiare.

7.2.4. Punonjësit e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë - Punonjësit e AKI-së me ligj nuk janë shërbyes civilë, mirëpo megjithatë, legjislacioni që rregullon çështjet e shërbimit civil zbatohet ndaj AKI-së, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me ligj.

Në kohën kur bëhet përzgjedhja e zyrtarëve të AKI-së, personat e zgjedhur për punësim duhet të plotësojnë standardet strikte të sigurisë, të cilat përcaktohen në pajtim me ligjin në fuqi. Që

⁴⁰ Po aty

një kandidat të punësohet në AKI, ai duhet të vlerësohet stabil, i besueshëm dhe me karakter, vlerësim dhe diskrecion të shkëlqyeshëm përndryshe leja e sigurisë refuzohet. Kandidatët asesi nuk punësohen nga AKI-ja nëse nuk i nënshtrohet procedurës së lejes së sigurisë ose dështojnë të plotësojnë kërkesat e parashtruara nga AKI-ja.⁴¹

Punonjësit e AKI-së nuk mund as të jenë anëtarë të partive politike as të marrin udhëzime prej partive, organizatave politike apo individëve jashtë AKI-së, e as nuk mund të kryejnë çfarëdo aktiviteti apo detyra tjera publike apo profesionale me pagesë, të cilat nuk janë në përputhje me punën e AKI-së. Nëse ata dëshirojnë ti bashkohen ndonjë organizate apo grupi duhet të kërkojnë miratimin paraprak të drejtorit, dështimi për të raportuar këtë ofron bazë për suspendim apo përjashtim të punonjësit.⁴² Ata nuk mund të japin deklarata publike apo të komentojnë punën e AKI-së apo të ofrojnë informacion personave të paautorizuar mbi të dhënat, dokumentet, kontaktet, qëllimet, dijen apo personelin e AKI-së pa miratim paraprak të drejtorit. Punonjësit e AKI-së zakonisht nuk mbajnë armë, përveq nëse drejtori i AKI-së vendosë ndryshe për një periudhë të kufizuar kohore ku të autorizuarit për armëmbajtje duhet së pari të jenë të kualifikuar për mbajtjen e asaj arme.⁴³

Punonjësit mund të shpallen përgjegjës për shkelje të detyrës zyrtare ku këto procedura për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore brenda agjencisë udhëhiqen nga procedurat e brendshme. Punësimi i punonjësve të AKI-së ndërpritet në këto raste: dorëheqja vullnetare; përfundim i kontratës; arritja e moshës së pensionimit; paaftësia e përhershme për kryerjen e detyrave zyrtare për shkak të kushteve shëndetësore; humbja e shtetësisë së Kosovës; marrja vullnetare e shtetësisë së një vendi tjetër pas fitimit të punësimit në agjenci; shkurtime të vendeve të punës; dënimi për vepra penale që bart ndëshkim me burg; dhe përjashtimi nga shërbimi si rezultat i procedurës disiplinore.⁴⁴

⁴¹ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

⁴² Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

⁴³ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, E drejta për Armëmbajtje

⁴⁴ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Ndërprerja e Punësimit

8. RENDËSIA E INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

Njëri prej ligjeve që ka rol qenësor në mbarëvajtjen e gjithë procesit të inteligjencës është edhe Ligji mbi Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Ky ligj është miratuar dy vite pas hyrjes në fuqi të Ligjit për AKI, pra në Korrik të vitit 2010. Ky ligj ka një sistem unik në secilin shtet mbi klasifikimin e të dhënave në mënyrë që të sigurohet në masë të lartë që të gjitha dokumentet që u vëhet shkalla e klasifikimit të jenë në nivelin e duhur si dhe që çdo person i cili mund të ketë çasje në to të jetë person i besueshëm. Ky ligj përpos që zbatohet ndaj të gjitha institucioneve të Kosovës zbatohet edhe ndaj gjithë personave fizik dhe juridik që kanë çasje në këto informacione. AKI si çdo shërbim tjetër sekret është i autorizuar të mbledhë, mbajë dhe shpërndajë për qëllime të ligjshme qeveritare informacion. Kuptohet që këto aktivitete rregullohen me procedura strikte në pajtueshmëri me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe nevojës, dhe vetëm për avancim të sigurisë kombëtare.⁴⁵

Informacionet mund të klasifikohen vetëm nëse në mënyrë të përgjegjshme dhe me logjikë të shëndoshë vlerësohet që mosklasifikimi i informacionit të caktuar ndikon në rrezikimin e sigurisë së vendit dhe vetëm nëse kjo bëhet nga autoriteti kompetent i klasifikimit i cili autoritet njëkohësisht vendos edhe për nivelin e klasifikimit varësisht nga shkalla e demit që ajo mund të shkaktojë në interes të sigurisë së vendit. Vendimi nëse duhet klasifikuar informacioni dhe përcaktimi i nivelit të klasifikimit bazohet në një vlerësim të pasojave të dëmshme që mund të rezultojnë për interesat e sigurisë së vendit nga hapja e paautorizuar e informacionit të tillë, vlerësim ky i cili bëhet me shkrim dhe i bashkëngjitet si shtojcë dokumentit që përmban informacionin e klasifikuar.⁴⁶

Disa prej kriterëve të cilat përcaktojnë mundësinë që informacionet të klasifikohen janë: siguri publike; mbrojtje, plane ushtarake, sisteme armësh, apo operacione; informacione për marrëdhëniet me jashtë dhe qeveritë e jashtme, përfshirë burimet konfidenciale; veprimtari zbulimi dhe të zbatimit të ligjit, përfshirë metoda dhe burime të zbulimit; sisteme, instalime,

⁴⁵ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Mbledhja, Ndarja dhe Mbrojtja e Informacionit

⁴⁶ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë së vendit; veprimtari shkencore, teknologjike, ekonomike, financiare që lidhen me interesat thelbësore të sigurisë së Republikës së Kosovës.⁴⁷

Me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë janë të përcaktuara edhe rastet kur ndalohet klasifikimi i informacioneve ku përfshihen: fshehja e shkeljeve të ligjit, abuzimi i autoritetit, paafektshmëria apo gabimi administrativ; parandalimi i turpërimit të një personi, autoriteti publik apo organizate; për të ndaluar konkurrencën; apo parandaluar dhe vonuar publikimin e një informacioni, i cili qartazi nuk ka të bëjë me çështje të sigurisë.⁴⁸

8.1. Nivelet e Klasifikimit

Informacioni mund të klasifikohet në njërin nga këto katër nivele, i cili përcaktohet nga autoriteti i klasifikimit:

Tepër Sekret i cili zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave sipas vlerësimit të arsyeshëm do të shkaktonte dëm jashtëzakonisht të rëndë për interesat e sigurisë së vendit, i cili informacion mund të deklasifikohet 25 vite pas datës së vendimit të klasifikimit;

Sekret që zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do t'i dëmtonte seriozisht interesat e sigurisë vendore, i cili informacion mund të deklasifikohet 15 vite pas datës së vendimit të klasifikimit;

Konfidenciale nivel ky që zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do të mund t'i dëmtonte interesat e sigurisë së vendit, i cili informacion mund të deklasifikohet 5 vite pas datës së vendimit të klasifikimit;

⁴⁷ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

⁴⁸ Po aty

E Kufizuar që zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do të ishte e pafavorshme për interesat e sigurisë së vendit, i cili informacion mund të deklasifikohet 1 vit pas datës së vendimit të klasifikimit.⁴⁹

Këto informacione mund të deklasifikohen në mënyrë automatike, pra për aq sa është e përcaktuar me ligj, mirëpo ekziston mundësia që informacione të caktuara të kërkojnë mbrojtje më të gjatë, ku në këtë rast Autoriteti Klasifikues vendos për periudhen e klasifikimit i cili vendim duhet të mirret jo më herët se 6 muaj para deklasifikimit të informacionit.

Kompetencën për Klasifikim e ka vetëm institucioni publik që e ka prodhuar atë informacion. Kompetenca varet edhe nga niveli i klasifikimit. Kështu niveli *Tepër Sekret* i klasifikimit, duke mos përjashtuar mundësinë që kjo kompetencë të delegohet tek vartësit e tyre të drejtëpërdrejtë mund të bëhet nga:

- Presidenti i Kosovës,
- Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
- Kryeministri,
- Kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës;
- Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës.⁵⁰

Kompetencën për klasifikim në nivelin *Sekret*, *Konfidenciale* dhe *E Kufizuar* e kanë sekretarët e përhershëm, kryeshefat apo drejtorët ekzekutivë të institucioneve publike dhe pozicionet e barasvlershme me ta, ku edhe këta mund të ia delegojnë këtë kompetencë zyrtarëve të lartë vartës. Njëherit zyrtarët e autorizuar për klasifikimin e informacioneve në një nivel të përcaktuar e kanë të drejtën t'i klasifikojnë informacionet edhe në nivel më të ulët.⁵¹

⁴⁹ Ligji për Klasifikimin e Informacionëve dhe Verifikimin e Sigurisë, Nivelet e Klasifikimit

⁵⁰ Ligji për Klasifikimin e Informacionëve dhe Verifikimin e Sigurisë, Kompetencat e Klasifikimit

⁵¹ Ligji për Klasifikimin e Informacionëve dhe Verifikimin e Sigurisë

8.2. Deklasifikimi i Informacionit

Informacioni deklasifikohet nga Autoriteti i Klasifikimit nga i cili informacioni i klasifikuar e ka origjinën atëherë kur nuk ka më nevojë për mbrojtje dhe në rastet kur nuk përmbushen kriteret për klasifikim të informacionit. Poashtu mund të deklasifikohen informacionet e klasifikuara të qeverive të huaja nga institucionet e Kosovës vetëm nëse informacionet e tilla janë deklasifikuar nga autoriteti i huaj i klasifikimit që i ka klasifikuar informacionet.⁵² Çdo pesë vite bëhet një rishikim për të verifikuar nëse informacionet e klasifikuara vazhdojnë të kërkojnë mbrojtje në pajtim me kriteret e klasifikimit të përcaktuara nga Autoriteti i Klasifikimit që ka prodhuar informacione të klasifikuara.⁵³

8.3. Siguria e Përsonelit

Leja e Sigurisë është një prej mjeteve më të rëndësishme që luan rolin kryesor në përzgjedhjen e anëtarëve të agjencisë. Qëllimi i procedurës së verifikimit të sigurisë është që të zbulojë nëse një person paraqet rrezik të papranueshëm për sigurinë shtetërore dhe në rast se një person refuzon të marrë pjesë në procedurën e verifikimit të sigurisë, ai automatikisht përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë. Ajo i jepet zyrtarëve për të pasur qasje në dokumentet e klasifikuara nëse nga kjo informatë e caktuar varet kompletimi i misionit të tyre zyrtar. Për të pasur qasje në informacionet e klasifikuara duhet më parë të nënshkruhet deklarata e konfidencialitetit. Përpos artyre që plotësojnë këto kushte, qasje në informacionet e klasifikuara dhe pa pasur nevojë të posedojnë lejen e sigurisë kanë edhe Presidenti i Kosovës, Kryetari i Kuvendit si dhe Kryeministri.⁵⁴ Lejen për të pasur qasje në informacionet e klasifikuara duhet ta rrespektojnë dhe duhet mbrojtur informacioni pavarësisht rrethanave, dhe pavarësisht periudhes së qëndrimit në pozitën e caktuar.

Deklarata e konfidencialitetit shërben për të dëshmuar që zyrtarët kanë qasje dhe shfrytëzojnë informacionet e klasifikuara vetëm me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare; njohin legjislacionin relevant që ka të bëjë me qasjen në informacione dhe ruajtjen e informacioneve të klasifikuara si dhe sanksionet përkatëse ligjore për mosrespektimin e tyre; do të përdorin

⁵² Ligji për Klasifikimin e Informacionëve dhe Verifikimin e Sigurisë, Deklasifikimi

⁵³ Ligji për Klasifikimin e Informacionëve dhe Verifikimin e Sigurisë, Deklasifikimi

⁵⁴ Ligji për Klasifikimin e Informacionëve dhe Verifikimin e Sigurisë, Leja e Sigurisë

informacionet e klasifikuara që i kanë në posedim strikt në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe çdo legjislacioni tjetër relevant; si dhe nuk do të publikojnë informacionet e klasifikuara që i kanë në posedim si dhe ndonjë njohuri tjetër që kanë lidhur me ato informacione gjatë dhe pas periudhës sa të jenë në detyrë para ndonjë personi të paautorizuar.⁵⁵ Qasja e zyrtarëve në informacionet e klasifikuara përcaktohet nga drejtuesi i institucionit publik, ku krijohen, përpunohen, ruhen, pranohen apo transmetohen këto informacione, i cili njëkohësisht duhet të sigurohet që këta persona i përmbushin kushtet e përcaktuara të cilat lejojnë qasjen në informacione të klasifikuara.⁵⁶

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është Autoriteti Verifikues që ka përgjegjësi për të zhvilluar procedura të verifikimit të sigurisë, siç është përcaktuar me këtë ligj, për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe kontraktuesve të tyre.⁵⁷ Këtë ajo e bënë duke themeluar një departament të veçantë verifikimi i cili është ekskluzivisht përgjegjës për të zbatuar procedurat e verifikimit të sigurisë. Departamenti i Verifikimit të Sigurisë dhe të gjithë të punësuarit dhe personeli i angazhuar në të duhet të jenë politikisht të paanshëm, profesional, të veprojnë vetëm në pajtim me ligjin dhe nuk duhet të marrin udhëzime nga ndonjë person apo institucion.⁵⁸

Autoriteti Verifikues ia lëshon lejen mbi sigurinë vetëm atij personi, i cili pas kryerjes së një procedure të verifikimit të sigurisë në pajtim me këtë ligj është përcaktuar si rrezik i pranueshëm për sigurinë.⁵⁹ Në leje të sigurisë tregohet qartë niveli i informacionit të klasifikuar, në të cilën personi që e ka kaluar procedurën e verifikimit të sigurisë mund të ketë qasje me ç'rast kjo leje e sigurisë e një niveli të caktuar të klasifikimit i jep automatikisht bartësit qasje edhe në informacionet me nivel më të ulët të klasifikimit.⁶⁰ Çdo institucion publik i bindet vendimit të Autoritetit Verifikues dhe nuk i jep qasje në informacione të klasifikuara një personi të cilit i është refuzuar leja e sigurisë.

Rastet kur mohohet qasja në informacionet e klasifikuara janë: nëse zyrtari nuk është lojal ndaj shtetit dhe vlerave të tij kushtetuese; nëse ai mund të manipulohet, nxitet ose shantazhohet për të ndihmuar një grup, ndonjë person, organizatë ose qeveri të huaj në mënyrë të dëmshme për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës; ose nëse sillet në një mënyrë që tregon

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

⁵⁷ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

⁵⁸ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

⁵⁹ Po aty

⁶⁰ Po aty

personalitet me çrregullime emocionale apo mendore, mungesë gjykimi ose dëshire, mos-sinqeriteti, vet-kontrolli ose mungesë të vullnetit për t'iu bindur rregullave në mënyrë që ngritë dyshime rreth përgjegjshmërisë së atij personi, besueshmërisë dhe aftësisë për t'i mbrojtur informacionet e klasifikuara.⁶¹ Një person mund të konsiderohet si rrezik i papranueshëm për sigurinë edhe në rastet kur bashkëshorti/ja i/e tij/saj përmbushë njëren nga këto që u përmendën më lartë.⁶²

Ekzistojnë gjithsej tri lloje të procedurave të verifikimit të sigurisë të cilat ndahen në:

Procedura e thjeshtë e verifikimit të sigurisë e cila zbatohet ndaj personave të cilët duhet të kenë qasje në informacionet e klasifikuara si “KONFIDENCIALE”. Me këtë rast autoriteti verifikues brenda tre muajve verifikon nëse informacionet e dhëna në pyetësorin e sigurisë janë të plota dhe të sakta dhe inspekton regjistrat e statusit civil, dosjet mbi veprat penale dhe çfarëdo regjistri apo bazë të të dhënave tjetër zyrtare kombëtare apo ndërkombëtare.

Procedura e zgjatur e verifikimit të sigurisë zbatohet ndaj personave të cilët duhet të kenë qasje në informacione të klasifikuara të nivelit jo më të lartë se “SEKRET”. Përpos veprimeve që ndërmerren gjatë procedurës së verifikimit të thejstë, autoriteti verifikues urdhëron kontrollimin shëndetësor nëse kjo konsiderohet e nevojshme për të verifikuar informacionet lidhur me përdorimin, varësive të alkoolit dhe drogës, ose ndonjë çrregullimi mendor apo emocional; kërkon informacione nga institucionet e sigurisë të Kosovës nëse kjo konsiderohet e nevojshme për të verifikuar informacionet lidhur me kontaktet me qeveritë e huaja si dhe shërbimet e huaja të zbulimit dhe informacione të ngjashme; hyn në bilancet e llogarive bankare dhe kërkon nga bankat dhe institucionet tjera bankare informacione lidhur me borxhet; bënë intervista me fqinjët në vendin e banimit dhe me punëdhënësit aktual dhe të mëparshëm.⁶³ Kjo procedurë e verifikimit të sigurisë përfundon brenda gjashtë muajve nga dita e fillimit të procedurës.

Procedura e veçantë e verifikimit të sigurisë zbatohet ndaj personave të cilët duhet të kenë qasje në informacionet e klasifikuara si “TEPËR SEKRET”. Për zhvillim të procedurës së veçantë të verifikimit të sigurisë, përpos të gjitha veprimeve që merren gjatë dy procedurave të sipërpermendura të verifikimit kërkohet që edhe nga bashkëshorti/ja të plotësohet një

⁶¹ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

⁶² Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

⁶³ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

pyetësor i sigurisë. Përveç kësaj, autoriteti verifikues zhvillon intervista me personin që i nënshtrohet verifikimit të sigurisë, me bashkëshortin/en dhe personat e paraqitur në listë si referencë. Procedura e veçantë e verifikimit të sigurisë përfundon brenda nëntë muajsh nga dita e fillimit të procedurës.⁶⁴

⁶⁴ Po aty

9. KONTROLLI NGA INSTITUCIONET SHTETËRORE

9.1. Bashkëpunimi brenda shtetëror

Shërbimi i inteligjences si dhe i informacioneve të fshehta kontrollohet nga qeveria e një shteti, mbikëqyret nga ana e parlamentit si dhe monitorohet nga ana e gjyqësorit.⁶⁵ Shërbimi inteligjent nënkupton që mënyra e veprimit të agjencive të kësaj natyre është sekrete me ç'rast konsiderohet të jetë mënyra e vetme që gjatë kryerjes së detyrave të veta ajo të ketë rezultate pozitive në këtë lëmi. Pra, kjo mënyrë sekrete e veprimit të saj ndikon që të arrihet sigurimi i informatave në lidhje me ndonjë rrezik të mundshëm dhe mbrojtja e vendit nga dukuritë negative të shkaktuara kryesisht nga faktori njeri. Kjo gjë vërehet sidomos në Kosovë, pasi institucionet e Kosovës me anë të ligjit të AKI-së e kanë themeluar këtë agjenci si një institucion mjaftë jo transparent. Përkundër faktit që veprimtaria e këtyre agjencive jo gjithmonë konsiderohet nga publiku i gjërë si mënyra më e mire për të vepruar, që konsiston në përdorimin e metodave sekrete apo bërjen e dredhinave, kjo është dëshmuar të jetë mënyra më efektive për tu mbrojtur nga armiku potencial. Në të kundërtën, nëse çdo veprim i ndërmarrë nga shërbimi i inteligjences do publikohej, atëherë kjo do zvogëlonte mundësinë e zbulimit të rasteve që mund të jenë kërcënuese për sigurinë e shtetit në përgjithësi. Megjithatë, mënyra e vetme që institucionet e shërbimeve të fshehta të konsiderohen demokratike është nëse ato janë të ndërtuara nga institucionet shtetërore, pra nëse e kanë bazën ligjore, nëse informatat e siguruar përdoren vetëm për qëllime të sigurisë shtetërore, dhe nuk bëhen keqpërdorime për të arritur interesat dhe qëllimet personale që mund të ndikojnë në keqpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve.

Sipas H. Born dhe I. Leigh standardet dhe praktika më e mire ka treguar që duhet të krijohen katër nivele të mbikëqyrjes së shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit siq janë:

- Kontrolli i brendshëm në nivelin e agjencisë

⁶⁵ H. Born and I. Leigh (2005) Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies, DCAF, Parliament of Norway, Oslo

- Kontrolli nga ana e ekzekutivit
- Mbikëqyrja parlamentare
- Mbikëqyrja nga ana e organeve të pavaruara të mbikëqyrjes⁶⁶

Në kontrollin e brendshëm të agjencisë përfshihen çështje të tilla si zbatimi i duhur i ligjeve dhe politikave qeveritare, funksioni i kreut të agjencisë, administrimi i duhur i informacioneve e të tjera. Ku ky kontroll shërben si bazë e mbikëqyrjes demokratike nga ana e organeve tjera shtetërore. Ekzekutivi përcakton detyrat dhe përparësitë e shërbimeve, kontrollin e tyre dhe të operacioneve të fshehta, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe masat mbrojtëse kundër shpërdorimit nga ana e ministrave. Parlamenti ka rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e politikës së përgjithshme, financat dhe ligjshmerinë e shërbimeve të inteligjencës. Organet e pavarura të mbikëqyrjes lidhen me një kontroll të pavarur nga ana dhe pikëpamja e qytetarit (ku hyjnë: avokati i popullit, inspektori i përgjithshëm si dhe zyrat e pavarura të kontrollit).⁶⁷ Përpos këtyre, duhet përmendur rolin e gjyqësorit i cili kryesisht ka të bëjë me dhënien e autorizimeve agjencisë për kryerjen e detyrave të saja dhe merret me çështjet e hetimit të rasteve të keqpërdorimit të informacioneve dhe të tjera çështjeve të kësaj natyre nga ana e agjencisë.

9.2.Mbikëqyrja nga ana e Ekzekutivit – Qeveria

Në shoqëritë demokratike ekzekutivi në përgjithësi bënë kontrollin e shërbimeve të inteligjencës. Anëtarët e ekzekutivit krijojnë politikat gjithëpërfshirëse dhe prioritetet për shërbimet e inteligjencës. Përveç kësaj, ekzekutivi është politikisht përgjegjës për shërbimet e inteligjencës, por i jep llogari parlamentit dhe publikut për aktivitetet e inteligjencës.⁶⁸

Për arsye praktike dhe për shkak të natyrës së ndjeshme të kësaj teme, kontrollin efektiv jashtë agjencisë duhet ta ushtrojë qeveria – ekzekutivi. Mes kontrollit nga ana e ekzekutivit

⁶⁶ H. Born and I. Leigh (2005) Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies, DCAF, Parliament of Norway, Oslo

⁶⁷ H. Born and I. Leigh (2005) Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies, DCAF, Parliament of Norway, Oslo

⁶⁸ Wills, Aidan (2007) Understanding Intelligence Oversight, DCAF

dhe mbikëqyrjes parlamentare nuk ka ndonjë konflikt të brendaqenësishëm.⁶⁹ Përkundrazi: mbikëqyrja efektive parlamentare varet nga kontrolli efektiv i agjencisë nga ana e ministrave. Ekzekutivi është përgjegjës për autorizimin e aktiviteteve të inteligjencës që përbëjnë një rrezik të madh për sigurinë e individëve, marrëdhëniet e huaja të shtetit dhe reputacionin e tij.⁷⁰ Në autorizimin e këtyre aktiviteteve ekzekutivi merr përgjegjësinë politike dhe gjithashtu ofron kontroll shtesë mbi shërbimet e inteligjencës. Ekzekutivi mbikëqyrë shërbimet e inteligjencës për të siguruar që ato kryejnë funksionet e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjin. Nëse ndodhë të bëhen akuza kundër shërbimit të inteligjencës për shkelje, ekzekutivi mund të fillojë hetimet në aktivitetet e veçanta të shërbimit inteligjent. Përderisa aktivitetet e shërbimeve të fshehta janë të bazuara në statutet, ekzekutivi nxjerrë rregullore për të ndihmuar në sqarimin dhe zbatimin e ligjeve. Për shembull, ekzekutivi mund të nxjerrë udhëzime për standardet etike të bazuara në statutet në lidhje me shërbimet e inteligjencës. Poashtu në Kosovë qeveria definoi parimet e përgjithshme të koordinimit dhe asistencës ndërmjet dhe brenda agjencisë dhe organeve e institucioneve shtetërore, nën mbikëqyrjen e kryeministrit. Ajo poashtu mund të ofrojë përkrahje në fushën e inteligjencës, duke përfshirë edhe ndihmë të ekspertëve, institucioneve tjera qeveritare sipas nevojës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës.

9.3.Mbikëqyrja nga ana e Legjislativit – Parlamenti

Parlamenti ka rolin kryesor në mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës. Rëndësia kryesore e tij qëndron në faktin që ai fillimisht drafton dhe aprovon ligjet që në parim rregullojnë gjithë veprimtarinë e shërbimit inteligjent. Kjo përfshinë edhe themelimin e institucioneve për mbikëqyrjen e këtij shërbimi. Parlamenti në Kosovë ka rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e politikës së përgjithshme, financat dhe ligjshmerinë e shërbimeve të inteligjencës. Mbikëqyrja e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë kryhet nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë. Përbërja e tij përcaktohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, i cili takohet të paktën dy here në vit.⁷¹ Ky komision aktualisht përbëhet nga gjithsej nëntë zyrtar

⁶⁹ H. Born and I. Leigh (2005) Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies, DCAF, Parliament of Norway, Oslo

⁷⁰ Po aty

⁷¹ Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës

prej tyre kryetari dhe dy zëvendëskryetar, pra zëvendëskryetari i parë dhe i dytë. Kryetari i këtij komisioni aktualisht nuk është dhe nuk duhet të jetë anëtar i partisë politike apo koalicionit qeverisës që është në pushtet. Ai thirr mbledhjet me iniciativën e vet, mirëpo është i obliguar të thirr mbledhjet e organit mbikëqyrës parlamentar pas marrjes së kërkesës me shkrim të një të tretës së anëtarëve të organit mbikëqyrës parlamentar.⁷² Ndërveprimi ndërmjet AKI-së dhe komisionit mbikëqyrës parlamentar zakonisht është i mbyllur për publik përveç nëse specifikohet ndryshe nga kryesuesi i komisionit mbikëqyrës parlamentar apo pas rekomandimit dhe votimit të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të komisionit mbikëqyrës parlamentar.⁷³ Njëra prej detyrave të komisionit mbikëqyrës parlamentar është të ofrojë një mendim për propozimin e detajizuar të buxhetit për AKI-në si dhe të kryejë hetime në lidhje me punën e AKI-së.⁷⁴

Mbikëqyrja në fushën e sigurisë nga ana e parlamentit bëhet në mënyrë që të zvogëlohet mundësia e shpërdorimit të mundshëm nga ana e qeverisë, në rast që kjo mbikëqyrje do bëhej vetëm nga ana ekzekutivit. Parlamenti përpos që përcakton kornizën ligjore, ai poashtu merr përsipër detyrën e shqyrtimit në mënyrë të hollësishme të veprimtarisë së qeverisë.⁷⁵ Pjesëmarrja e parlamentit jep legjitimitet dhe kontrollueshmëri demokratike. Ajo mund të kontribuojë për të garantuar që organizatat e sigurisë dhe të shërbimit inteligjent të i shërbejnë shtetit në tërësi dhe të mbrojnë kushtetutën dhe jo interesat politike apo individuale.⁷⁶ Kontrolli i duhur siguron një politikë të qëndrueshme ndaj sigurisë, që është pozitive si për shtetin ashtu edhe për vetë agjencinë. Angazhimi i parlamentarëve mund të kontribuojë për të garantuar që përdorimi i parave publike për shërbimet e fshehta të sigurisë dhe informacionit të autorizohet dhe të shpjegohet si duhet.

Në rastet e hetimeve parlamentare komisioni mbikëqyrës parlamentar merret me mbikëqyrjen e punës së AKI-së me ç'rast ai mund të kryejë hetime nëse beson që AKI-ja po kryen detyrat e veta në mënyrë të paligjshme apo joprofesionale. Gjatë këtij hetimi komisioni mund të marrë në pyetje punonjësit e AKI-së si dhe të ketë qasje në dokumentet relevante të AKI-së, ku edhe në këtë rast hetimet parlamentare janë të mbyllura për opinionin përveç nëse caktohet ndryshe nga kryesuesi i organit mbikëqyrës parlamentar ose pas rekomandimit dhe votimit të

⁷² Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës

⁷³ Po aty

⁷⁴ Po aty

⁷⁵ H. Born and I. Leigh (2005) Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies, DCAF, Parliament of Norway, Oslo, faqe 81

⁷⁶ H. Born and I. Leigh (2005) Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies, DCAF, Parliament of Norway, Oslo, faqe 81

shumicës së thjeshtë të anëtarëve të komisionit.⁷⁷ Nëse konstatohet se AKI-ja ka vepruar në mënyrë të paligjshme, atëherë komisioni fton kryeministrin për të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të iniciojë shqyrtimin e përgjegjësisë.⁷⁸ Gjatë kryerjes së funksionit të vet, komisioni mbikëqyrës parlamentar mund të kërkojë informacion nga kryeministri, drejtori i AKI-së, ose cilido Punonjës i AKI-së, poashtu ai mund të urdhërojë Drejtorin e AKI-së që para tij të japë raport gojor në lidhje me aktivitetet e Agjencisë.⁷⁹ Edhe pse në një rast të këtillë vihet në dispozicion informacioni i klasifikuar, ku përjashtim bën ai lloj informacioni shpalosja e të cilit do të kërcënonte interesat vitale të sigurisë kombëtare, me ç'rast Kryeministri apo drejtori i AKI-së informojnë me shkrim komisionin mbikëqyrës parlamentar me shpjegimin për mosfrimin e atij informacioni.⁸⁰

9.4.Roli i Gjyqësorit

Gjykata autorizon dhe mbikëqyrë përdorimin e shërbimit inteligjent. Gjykata merret me ankesat kundër agjencisë dhe parashikon mjetet që duhet zbatuar ndaj tyre duke vënë kështu standarde për kontrollimin e sjelljes në të ardhmen të shërbimeve të inteligjencës. Poashtu gjykata vendosë për çështjet që lidhen me çasjen në informacionet e shërbimeve të fshehta. Ajo poashtu gjykon rastet e ngritura kundër personave të akuzuar që në mënyrë të paligjshme të kenë zbuluar të dhënat e klasifikuara të mbajtura nga agjencia.

Siq është përmendur më lartë, AKI-ja në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë të veta, mund: të mbledhë informacion duke fshehur arsyet për mbledhjen e tij për shkak të natyrës sekrete të tij; të krijojë kontakte të fshehta me individë privatë; të krijojë dhe përdorë sisteme informacioni për avancimin e mbledhjes së inteligjencës; të përdorë forma të mashtrimit operativ që nuk shkaktojnë lëndime fizike apo dëmtojnë shëndetin; të përgatisë dhe përdorë dokumente mbulesë për mbrojtjen e punonjësve të AKI-së dhe personave fizikë që bashkëpunojnë me ta, si dhe fshehjen e qëllimit të sigurisë së tyre; të krijojë dhe mbajë organizata të përkohshme për qëllime të mbledhjes së fshehtë të të dhënave; dhe të caktojë punonjës të AKI-së të punojnë në fshehtësi në institucione apo organe të Kosovës.⁸¹ Përgjimi

⁷⁷ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

⁷⁸ Po aty

⁷⁹ Po aty

⁸⁰ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

⁸¹ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

nga ana e zyrtarëve të AKI-së në vende jopublike, përgjimi i telekomunikacioneve, hyrja në prone pa pajtim të pronarit dhe të gjitha format e përgjimit elektronik mund të behën vetëm me autorizim paraprak nga ana e gjyqtarit të Gjykatës Supreme dhe aprovuar nga drejtori apo zëvendës drejtori i AKI-së. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës është në proces të caktimit të një gjyqtari i cili do të merret vetëm me çështjet e AKI-së, i cili paraprakisht duhet të kalojë nëpër një procedurë të verifikimit.⁸² Gjyqtari i Gjykatës Supreme është i detyruar të ruaj fshehtësinë në lidhje me informacionin e fituar. Mënyra e përgjimit duhet të jetë e përshkruar në mënyrë precise duke përshkruar qartë llojin e informacionit, vendin ku do të behët përgjimi, periudhen gjatë së ciles planifikohet të bëhet përgjimi e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 60 ditë. Të gjitha këto duhet të arsyetohen me shkrim, në mënyrë që të vërtetohet që AKI-ja është duke mbledhur inteligjencë lidhur me një kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës. Gjyqtari duhet të merr vendimin brenda 48 orësh prej paraqitjes së kërkesës i cili urdhër për përgjim përcakton periudhën kohore e cila poashtu mund të zgjatet duke paraqitur arsyetimin për zgjatjen e propozuar.⁸³ Përdorimi i një teknike përgjimi ndërpritet menjëherë nëse objektivat e parashtruara në urdhrin e gjyqtarit janë arritur apo nëse nuk mund të priten rezultate të mëtejme nga përdorimi i vazhduar i saj.⁸⁴ Të dhënat personale të mbledhura nga AKI-ja duhet të ruhen për qëllime të specifikuara dhe legjitime vetëm gjatë kohës sa është e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj. Në momentin kur është e panevojshme të mbahen të dhënat personale nga AKI-ja, ato duhet të asgjësohen sipas mënyrës së përcaktuar me rregulla të brendshme.⁸⁵ Punonjësit e AKI-së duhet të mbrojnë informacionin e klasifikuar dhe si kusht punësimi të nënshkruajnë një marrëveshje për ruajtjen e fshehtësisë dhe ky obligim për të mbrojtur këto fshehtësi nuk pushon edhe kur punonjësi nuk është më i punësuar në AKI.⁸⁶ Zbulimi i informatave të klasifikuara të AKI-së paraqet shkelje të Kodit Penal të Kosovës, dhe kryesi i nënshtrohet dënimit siç parashihet në dispozitën përkatëse të kodit.⁸⁷

⁸² Intervistë e zhvilluar me Kryetarin e Gjykatës Supreme Fejzullah Hasani, 2010

⁸³ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

⁸⁴ Po aty

⁸⁵ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Trajtimi i të dhënave të mbledhura dhe ruajtura

⁸⁶ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Fshetësia

⁸⁷ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

9.5.Roli i Institucioneve të Pavarura Shtetërore, Shoqërisë Civile dhe Mediave

Njeri prej institucioneve të pavarura në Kosovë që ka rol të rëndësishëm në procesin e mbikëqyrjes së shërbimeve të inteligjencës është Avokati i Popullit i cili mbron të drejtat dhe liritë e personave nga veprimet e paligjshme apo mosveprimet e caktuara të autoriteteve publike. Ligjërisht Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet apo autoritetet tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në vend. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Kosovë, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.⁸⁸ Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit. Ai ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore, si dhe të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese.

Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut - Me ligj është e rregulluar që AKI-ja nuk vepron kundër të drejtave dhe interesave të asnjë komuniteti e as diskriminon ndonjë person mbi çfarëdo baze siq është gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja mendimi politik, prejardhja kombëtare apo shoqërore e të tjera.⁸⁹ Poashtu ligji specifikon që AKI-ja respekton ligjet ndërkombëtare në fuqi siq janë parimet e Deklarates Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventen Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore si dhe parimet tjera relevante të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura ndërkombëtarisht dhe kryen aktivitetet e veta në pajtueshmëri me to.⁹⁰ Me Kushtetutën e Kosovës garantohet respektimi i jetës private, privatësisë si dhe fshehtësia e korrespondencës si dhe komunikimeve tjera. Individët, institucionet dhe palët e treta kanë të drejtën e ankesës ndaj AKI-së. Ankesat mund t'i drejtohen Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës (IOK). Cilado ankesë e paraqitur IOK-së nuk cenon të drejtën e një individi, institucioni apo pale të tretë të kërkojë shqyrtim nga një gjykatë.

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit për një mandat pesë vjeçar, me

⁸⁸ Kushtetuta e Kosovës, Institucionet e pavarura, Kapitulli XII

⁸⁹ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

⁹⁰ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat.⁹¹ Fakti që Auditori është i përzgjedhur në këtë mënyrë zvogëlon mundësinë e keqpërdorimit të pozitës pasi ky kontroll zhvillohet njëkohësisht duke përfshirë ekzekutivin, dhe legjislativin (parlamentin) në gjithë procesin e kontrollueshmërisë financiare. Auditori i Përgjithshëm merret me kontrollimin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë. Kontrollimi i buxhetit nga ana e auditorit zvogëlon mundësinë e keqpërdorimit të buxhetit, dhe ndikon në shpenzimin e tij në proporcion me ligj dhe në mënyrë të drejtë. AKI burimet financiare për zhvillimin e veprimtarisë së saj i siguron nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Një rol të rëndësishëm e ka edhe shoqëria civile e cila mbikëqyrë nëse aktivitetet dhe operacionet e agjencisë së inteligjencës janë në pajtim me ligjin shtetëror dhe standardet ndërkombëtare. Në këtë mënyrë vlerësohet edhe efektshmëria e funksioneve në detyrat e tyre duke theksuar rendësinë e përputhshmërisë së tyre me ligjin dhe prioritetet shtetërore. Mbikëqyrja e vazhdueshme nga ana e shoqërisë civile dhe dhënia e këshillave të ekspertëve në fushën e sektorit të sigurisë dhe në veçanti në këtë fushë, ndikojnë në përmirësimin e gjithë procesit të inteligjencës dhe të transparencës së këtij shërbimi në përgjithësi, çfarë ndikon në mirëbësimin e qytetarëve në institucionet shtetërore dhe në veçanti të këtij shërbimi.

9.6. Roli i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Instituconet ndërkombëtare gjithashtu kanë rol të veçantë në shërbimin e inteligjencës. Pas ngjarjeve terroriste që kanë ndodhur në botë e që kishin efekte globale, gjithnjë e më tepër është duke iu shtuar rëndësia marrëdhënieve ndërkombëtre në këtë fushë. Kjo gjë shpesh realizohet me marrëveshje dypalëshe ndërmjet shtetëve për shkëmbim informacionesh për interesa të përbashkëta dhe çasjes më të madhe në informacione dhe shkëmbim të ekspertizës. Bashkëpunimi me agjencitë e huaja konsiderohet i nevojshëm për të kontribuar në luftimin e terrorizmit. Megjithatë duhet të i kushtohet një rëndësi të veçantë rregullimit ligjor për të minimizuar mundësinë e keqpërdorimit nga ndonjëra palë e këtyre marrëveshjeve. Një përparësi në këtë drejtim për Kosovën do të ishte edhe bashkëpunimi agjentëve lokal me agjentë tjerë në mbledhjen e informacionit që ndikon në ndarjen e dijes dhe ekspertizës, ku mund të përfshihen edhe ofrimi i trajnimeve nga vendet më të eksperiencuara në fushën e

⁹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës

shërbimeve të inteligjencës. Ky bashkëpunim ndikon edhe në efektivitetin e agjencive në rastet kur ato nuk kanë kapacitete, burime dhe ekspertizë për të mbledhur informacione në lidhje me kërcënimet që ekzistojnë në gjitha regjionet e botës.

10.GJETJET KRYESORE NË KUADËR TË FUNKSIONIMIT TË AKI

Duke u nisur nga fakti që Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është institucion relativisht i ri siq është edhe vet shteti i Kosovës me gjithë institucionet tjera të tij edhe ky institucion nuk përjashtohet nga niveli i në masë të kënaqshme i funksionimit. Ekzistojnë disa mangësi të konsiderueshme lidhur me mbarëvajtjen e shërbimit inteligjent të Kosovës të cilat përgjithësisht mund të ndahen në: Mangësi ligjore, Mangësi në Implementim si dhe Mungesë të Kapaciteteve Profesionale.

10.1. Mangësitë ligjore – Veprimtaria e AKI-së është e rregulluar me Kushtetutë si dhe me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë i hyrë në fuqi në Maj të vitit 2008. Ligji si i tillë e mbështetë transparencën mjaftë të kufizuar të kësaj agjencie kundrejt gjithë mekanizmave dhe institucioneve tjera në Kosovë. Një prej mangësive që mund të përfshihet këtu është që kuziston mungesë e harmonizimit të një pjese të legjislacionit i cili në një mënyrë apo tjetër është i lidhur me AKI dhe legjislacionin e shërbimit të inteligjencës. Disa prej këtyre ligjeve janë të kohës së UNMIK-ut, apo edhe nuk ekzistojnë fare. Në këtë rast vlenë të përmendën Ligji i Përkohshëm Penal dhe Ligji i Përkohshëm i Procedures Penale të cilët janë që nga koha e UNMIK-ut dhe ende nuk është bërë draftimi i tyre. Një tjetër mangësi është pra mungesa e një ligji që faktikisht e rregullon gjithë procesin me të cilit kryesisht vepron e gjithë Agjencia. Ky ligj është Ligji mbi Përgjimin e Komunikacionit i cili ende nuk është në agjenden e institucioneve vendore çka tregon që AKI në rastin e përgjimeve që tashme është duke bërë është duke vepruar në mënyrë joligjore.

10.2. Mangësitë në Implementim –Një mangësi që vërehet në sferen e implementimit është transparenca e agjencisë. AKI është njëra prej institucioneve më jo transparente në Kosovë. Deri me tani një pjesë e konsiderueshme e stafit të AKI-së është rekrutuar. Poashtu ka indikacione që në AKI struktura e personelit është e përbërë nga ish-pjesëtarë të policisë, që është një fakt për tu shqetësuar, pasi AKI nuk ka të drejtën ekzekutive dhe në këtë rast shumë nga pjesëtarët e saj vijnë nga pjesëtarët e një institucioni tërësisht ekzekutiv. Përpos këtij

fenomeni ku pjesëtarët vijnë nga një prapavijë policore, është prezent edhe fenomeni tjetër që është politizimi i AKI-së, e që nënkupton që stafi i rekrutuar kryesisht vjen nga qarqet e partive politike duke krijuar kështu mundësinë e keqpërdorimit të pozitës nga anëtarët e AKI për qëllime dhe interesa vetanake apo të partisë pjesë e së ciles janë ata. AKI tashme ka filluar të kryejë veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Kosovës duke përfshirë këtu edhe veriun e Kosovës, duke përdorur metoda të ndryshme për arritjen e qëllimve të tyre, duke filluar nga përgjimi me metoda të ndryshme që ka në dispozicion agjencia përderisa kjo fushë ende nuk është e rregulluar me legjislacion adekuat.

10.3. Mungesa e Kapaciteteve Profesionale – Siq është theksuar më herët AKI është një institucion i krijuar mjaftë vonë dhe i funksionalizimi i në një masë të caktuar ka filluar edhe më vonë. Mungesa e një institucioni të këtillë në të kaluarën shpalos një veti të theksuar me mungesë të stafit të profesionalizur dhe ekspertizës vendëse në këtë fushë. Përpos kësaj, duke pasur parasysh situatën e Kosovës ndër vite dhe nivelin e saj të edukimit duhet theksuar që edhe në këtë aspekt vërehet mungesa e kapaciteteve profesionale. Çështjet e sigurisë dhe studimet e kësaj fushe janë zhvilluar mjaftë vonë në Kosovë. Edhe ato që ekzistojnë janë mjaftë të nivelit të ulët kundrejt arsimimit të lartë ndërkombëtar. Ka fare pak ekspertë të sektorit të sigurisë në Kosovë. Kjo është një mangësi e cila mund të kompenzohet me bashkëpunim ndërkombëtar duke dërguar staf jashtë territorit të Kosovës për një trajnim më profesional në këtë fushë pasi edhe njëri prej kushteve për punësim në AKI është përvoja për punës në këtë fushë, përvojë profesionale që vështirë ta këtë pasur ndonjë prej të rekrutuarve.

11. PËRMBYLLJA

Përgjithësisht vlerësoj që nevoja për shërbimin e inteligjencës është mjaftë e nevojshme për çdo shtet demokratik duke u bazuar në aktet terroriste dhe krimet e kërcënimit e ndryshme që i kanosen vendeve në përgjithësi. Mirëpo rëndësi primare e secilit shtet demokratik është që rolin e agjencive të informacionit ta definojnë qartë në ligjet që i nxjerrë parlamenti, duke filluar nga pozita e këtij shërbimi – me çka dëshiroj të theksoj që shërbimi inteligjent kurrësi të mos qëndrojë mbi ligjin (çfarë ka dëshmuar praktika mjaftë në të kaluarën). Pra, çdo kompetencë e ushtruar nga shërbimet e fsheta duhet të jetë e bazuar në ligj. Duhet të krijohen mekanizmat për kontrollin kundër keqpërdorimit të kompetencave dhe të draftohen ligjet në atë mënyrë që të minimalizohet mundësia e keqpërdorimit, shpërdorimit dhe politizimit të shërbimit të inteligjencës nga politikanët brenda shtetit. Duhet të mbizotërojë parimi i proporcionalitetit i cili duhet të jetë i rregulluar me legjislacion ku definohet çartë mbikëqyrja e këtyre shërbimeve nga ana e institucioneve relevante. Kur është fjala për përdorimin e të dhënave personale duhet të i kushtohet një rëndësi të veçantë përdorimit të tyre duke mos lejuar që kjo të kalojë në dëmtim të integritetit të cilitdo qytetar të vendit. Në përgjithësi respektimi i legjislacionit dhe i gjitha rregulloreve që e definojnë dhe rregullojnë veprimtarinë e shërbimeve të inteligjencës dhe procesin e tyre duhet të jenë konform standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, ku kjo gjë ka rëndësi të posaqme në shërbimin inteligjent të Kosovës. Respektimi i të gjitha këtyre parimeve ndikon në mbarëvajtjen e gjithë procesit të inteligjencës në një shtet, marrëdhënie më të mira fqinjësore, zvogëlimin më eficient të terrorizmit e akteve të ndryshme kriminele, ngritjen e mirëbesimit të qytetarëve kundrejt institucioneve shtetërore si dhe në mirëqenine të përgjithshme.

12. REKOMANDIMET

Janë të listuara më poshtë një numër rekomandimesh të cilat kryesisht i adresohen Parlamentit përkatësisht Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë, Qeverisë, AKI-së si dhe institucioneve tjera përgjegjëse për mbarëvajtjen e gjithë procesit të inteligjencës.

- ❖ Të përmirësohet transparenca duke krijuar një mekanizëm i cili do të shërbejë për informimin e publikut për veprimtarinë e agjencisë, progresin e arritur dhe punonjësve të saj.
- ❖ Duhet të zhvillohet bashkëpunimi ndërmjet komisioneve parlamentare, më konkretisht të Komisionit për Legjislacion dhe atij për Mbikëqyrjen e AKI-së për të punuar drejt harmonizimit të legjislacionit: në këtë rast Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Duhet miratuar ligjet të cilat mungojnë e që janë drejtpërdrejtë të lidhura me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë si dhe integritetin e individëve. Në këtë rast vlenë të ceket mungesa e Ligjit mbi Përgjimit e Telekomunikacionit me të cilin ligj rregullohen kushtet dhe procedura e përgjimit të komunikimit, menyra e procedimit si dhe kontrolli i ligjshmerisë së përgjimit të komunikimeve.
- ❖ Një tjetër gjë që vlenë të theksohet në këtë drejtim është që në rastin e nxjerrjes së ligjeve të reja të i kushtohet një rendësi e veçantë që ato të jenë në përputhshmëri dhe ti plotësojnë standardet ndërkombëtare.
- ❖ Të krijohet një mekanizëm për mbikëqyrjen e veprimtarisë së AKI-së apo të funksionalizohen në nivelin maksimal mekanizmat ekzistues për të minimizuar mundësinë e keqpërdorimit të pozitës, apo të zvogëlohet mundësia e politizimit të çështjeve të lidhura me këtë sferë shtetërore mjaftë të ndjeshme.

- ❖ Duhet të bëhet qartë ndarja e përgjegjësive të secilit institucion dhe mekanizëm dhe të punohet në zhvillimin e një doze të proporcionalitetit të institucionve.
- ❖ Pasi vërehet mungesa e ekspertizës në këtë fushë shprehet nevoja që Institucionet e Kosovës të krijojnë mundësinë e trajnimit të stafit vendor jashtë shtetit.
- ❖ Të zgjerohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar ndërmjet zyrtarëve të shërbimit inteligjent në Kosovë në mënyrë që të lehtësohet identifikimi i rreziqeve dhe kërcënimeve të ndryshme ndërmjet shteteve.

BIBLIOGRAFIA

Literatura

Contemporary Security Studies, Alan Collins, Oxford University Press, New York, 2007

Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practice for Oversight of Intelligence Agencies, Hans Born dhe Ian Leight, DCAF, Parliament of Norway, Oslo, 2005

Çështjet e Sigurisë Nacionale të Kosovës, Ramadan Qehaja, Vatra, Prishtinë, 2004

Vlerësimi i Sektorit të Sigurisë në Republikën e Kosovës, QKSS, 2009

Understanding Intelligence Oversight, Aidan Wills, DCAF, 2007

Parliamentary Oversight of the Security Sector, Principles, mechanisms and practices, DCAF, Geneva, 2003

Çështje të Reformave në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri, IDN, Tiranë, 2009

Kontrolli Demokratik dhe Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake – Një çështje e Papërfunduar, IDN, Tiranë, 2009

Dokumentët Ligjore

Ligji i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës Nr. 03/L-063

Ligji mbi Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë Nr. 03/L-178

Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 03/L-172

Ligji për Përgjimin e Komunikacionit i Maqedonisë

Ligji për Përgjimin e Telekomunikimeve i Shqipërisë

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, 6 Korrik 2003

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, 6 Korrik 2003

Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 29 Prill 2009

Raporte

Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë, UNDP, 2006

Analiza e Kontekstit të Sektorit të Sigurisë në Kosovë 1999 – 2009, QKSS

Funksionet e Kontrollit të Institucioneve të Pavarura Shtetërore në Sektorin e Sigurisë në Kosovë, QKSS, Prishtinë, 2010

Handbook on Human Rights and Fundamental Freedoms of Armed Forces Personnel, OSCE, DCAF, 2008

Intelligence Practice and Democratic Oversight – A Practitioner's view, DCAF, 2003

Fighting the Pre-eminent Threats with Intelligence-led Operations, Fred Schreier, DCAF, Geneva, 2009

Sfidat bashkëkohore për komunitetin e inteligjencës, DCAF, Geneva, 2006

Shërbimet e Inteligjencës, DCAF, Geneva, 2006

Komisionet Parlamentare për mbrojtje dhe siguri, DCAG, Geneva, 2006

Internet

DCAF, Parliamentary Oversight <http://www.dcaf.ch/Topics/Detail?lng=en&id=121489>
Korrik, 2010

Hija – Bedri Islami <http://www.kosovarimedia.com/home/biblioteka/libra-shqip/96-enigma-e-nje-vrasje-te-trefishte-bedri-islami/1347-enigma-e-nje-vrasje-te-trefishte-hija-bedri-islami.html> Shtator, 2010

The History of Military Intelligence 5 <http://www.topspysecrets.com/mi5-history.html>
Shtator, 2010

MI6 Military Intelligence 6 <http://www.topspysecrets.com/mi6-military-intelligence.html>
Shtator, 2010

The Israeli Mossad <http://www.topspysecrets.com/israeli-mossad.html> Shtator, 2010

<http://www.sis.gov.uk/output/history-of-sis.html> Shtator, 2010

<http://www.nsa.gov/index.shtml> Shtator, 2010

The world of Secret Services, <http://www.topspysecrets.com/secret-services.html> Shtator,
2010

A Brief History of: The Secret Servicee,

<http://www.time.com/time/magazine/article/0,9171,1860895,00.html> Shtator, 2010

The History of CIA, <http://www.topspysecrets.com/central-intelligence-agency.html> Shtator,
2010

FBI - Federal Bureau of Investigation, <http://www.topspysecrets.com/federal-bureau-of-investigation.html> Shtator, 2010

NSA- National Security Agency, <http://www.topspysecrets.com/national-security-agency.html> Shtator 2010

The Russian KGB, <http://www.topspysecrets.com/russian-kgb.html> Shtator, 2010

KGB recruitment successes <http://www.topspysecrets.com/kgb-recruitment-success.html>
Shtator, 2010

The History of Military Intelligence 5 <http://www.topspysecrets.com/mi5-history.html>
Shtator, 2010

MI6 Military Intelligence 6 <http://www.topspysecrets.com/mi6-military-intelligence.html>
Shtator, 2010

The Israeli Mossad <http://www.topspysecrets.com/israeli-mossad.html> Shtator, 2010

<http://www.sis.gov.uk/output/history-of-sis.html> Shtator, 2010

Gazeta Zeri, <http://www.zeri.info/> 2010

<http://www.nsa.gov/index.shtml> Shtator, 2010

Serbia me dhunë po mëton ndarjen e Kosovës, Skender Mulliqi,

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:jJp60sjvY5UJ:www.gazeta55.al/gazeta/07.07.2010.pdf+rojat+e+ures+ne+veri+te+mitrovices+pdf&cd=6&hl=en&ct=clnk&source=www.google.com> Korrik, 2010

Enigma e Mohimit, Bedri Pejani, <http://www.kosovarimedia.com/home/biblioteka/libra-shqip/96-enigma-e-nje-vrasje-te-trefishte-bedri-islami/1346-enigma-e-nje-vrasje-te-trefishte-enigma-e-mohimit-bedri-islami.html> Korrik, 2010

Accountability of International Intelligence Cooperation <http://www.dur.ac.uk/hrc/>,
<http://www.eos-utvalget.no/hXGXCTgZfIWp.35.idium> Shtator, 2010

<http://www.eos-utvalget.no/filestore/EOSBriefingontherecordingofpersonaldata.pdf> Shtator, 2010

<http://www.kosovarimedia.com/home/biblioteka/libra-shqip/96-enigma-e-nje-vrasje-te-trefishte-bedri-islami/1347-enigma-e-nje-vrasje-te-trefishte-hija-bedri-islami.html> Korrik, 2010

<http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=119887> 2010

<http://www.kohajone.com/zarticle.php?id=58064> 2010

<http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/SMN%20ARJ.%20SHqip.pdf> Korrik, 2010